

Udhëzues

Të kuptuarit e mbikëqyrjes së inteligjencës

Aidan Wills



Geneva Centre for the
Democratic Control of
Armed Forces (DCAF)

Udhëzues

Të kuptuarit e mbikëqyrjes së inteligjencës

Aidan Wills



Geneva Centre for the
Democratic Control of
Armed Forces (DCAF)

Për DCAF-in

Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) promovon qeverisjen e mirë dhe reformimin e sektorit të sigurisë. Qendra bën hulumtime të praktikave të mira, inkurajon zhvillimin e normave të duhura në nivele shtetërore dhe ndërkombëtare, bën rekomandime për politika si dhe ofron këshilla e programe asistence edhe brenda vendeve. Partnerët e DCAF-it janë qeveritë, parlamentet, shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe aktorët e sektorit të sigurisë, si policia, gjyqësori, agjencitë e inteligjencës, shërbimet e sigurisë në kufi dhe ushtria.

Më shumë informata mbi DCAF-in gjenden tek:

www.dcaf.ch

Falënderime

DCAF-i dëshiron të falënderojë anëtarët e Redaksisë për dedikimin e tyre si dhe kohën që i kanë dhënë shqyrtimit të kësaj serie.

Më tutje, DCAF-i dëshiron të falënderojë Beverly Youmans dhe Stephanie Chaban për ndihmën e tyre në redaktim.

Botues

Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).

Foto e ballinës © REUTERS/ Chris Wattie, 2007

ISBN: 978-92-9222-131-7

© DCAF 2010. Gjitha të drejtat e rezervuara.

Redaksia

Redaksia për serinë e botimeve për mbikëqyrjen e inteligjencës përbëhet nga:

- Hans Born, Gjenevë
- Ian Leigh, Durham
- Arnold Luethold, Gjenevë
- Benjamin Buckland, Gjenevë

Pasqyra e përmbajtjes

Hyrje për Pakon e Instrumenteve	8
Të kuptuarit e mbikëqyrjes së Inteligjencës	10
Cili është synimi i këtij udhëzuesi?	10
Çfarë përmban ky udhëzues?	10
Për kë është ky udhëzues?	10
Çfarë janë shërbimet e inteligjencës?	10
Shërbimet e inteligjencës në shoqëri demokratike	11
Cili është roli i shërbimeve civile inteligjente në shoqëri demokratike?	11
Cili është roli i shërbimeve ushtarake të inteligjencës?	11
Korniza ligjore për shërbimet e inteligjencës	13
Si e sigurojnë shoqëritë demokratike bazën ligjore për shërbimet e inteligjencës?	13
Pse kanë nevojë shërbimet inteligjente për bazë ligjore?	13
A janë sekrete ligjet e inteligjencës?	14
Çfarë përfshijnë ligjet e inteligjencës?	14
Si sigurohet zbatimi i ligjit nga shërbimet e inteligjencës në shoqëritë demokratike?	15
Cilat janë standardet ligjore ndërkombëtare që vlejné për shërbimet e inteligjencës?	15
A lejohen shërbimet e inteligjencës të shkelin të drejtat e njeriut?	15
Grumbullimi i informatave	17
Si grumbullojnë informata shërbimet e inteligjencës?	17
Çfarë informatash lejohen të grumbullohen nga shërbimet e inteligjencës?	17
Çfarë informatash nuk lejohen të grumbullohen nga shërbimet e inteligjencës?	18
Pse shtetet kufizojné grumbullimin e informatave nga disa profesione të caktuara?	18
Si kontrollohet ushtrimi i kompetencave të veçanta në një shoqëri demokratike?	18
Kush autorizon ushtrimin e kompetencave të veçanta?	18
Si e autorizon shteti ushtrimin e kompetencave të veçanta?	19
Si e mbikëqyrin shoqëritë demokratike ushtrimin e kompetencave të veçanta?	19

Shfrytëzimi dhe menaxhimi i të dhënave personale	21
Çfarë janë të dhënat personale?	21
Si mbledhin të dhëna personale shërbimet e inteligjencës?	21
Si i përdorin të dhënat personale shërbimet inteligjente dhe qeveritë e tyre?	21
Pse shoqëritë demokratike kufizojnë shfrytëzimin e të dhënave personale?	22
Çfarë kontrollesh ligjore vlejné për shfrytëzimin e të dhënave personale?	22
Kush e mbikëqyrë shfrytëzimin e të dhënave personale, dhe çfarë bëjnë ata?	23
A munden individët të qasin të dhënat e tyre personale?	24
Bashkëpunimi ndërkombëtar i inteligjencës	25
Çfarë është bashkëpunimi ndërkombëtar i inteligjencës?	25
Pse bashkëpunojnë shërbimet e inteligjencës me qeveritë dhe shërbimet e huaja inteligjente?	25
Cilët janë rreziqet e bashkëpunimit të inteligjencës?	25
Si e kontrollojnë shtetet bashkëpunimin ndërkombëtar të inteligjencës?	26
Çfarë kontrollesh vlejné për ndarjen e informatave me shërbimet e huaja të inteligjencës?	26
Si mbikëqyret bashkëpunimi ndërkombëtar në inteligjencë?	27
Përdorimi i kompetencave të arrestimit dhe mbajtjes nga shërbimet e inteligjencës	27
A duhet që shërbimet e inteligjencës të kenë kompetencë të arrestojnë dhe mbajnë individë?	27
Çfarë standardesh ndërkombëtare vlejné për kompetencat e arrestimit dhe mbajtjes?	28
A kanë nevojë shërbimet e inteligjencës për objekte të veta të burgimit?	28
Përdorimi i forcës fatale nga shërbimet e inteligjencës	28
A lejohen shërbimet e inteligjencës të vrasin?	28
Kontrolli dhe mbikëqyrja e shërbimeve të inteligjencës	31
Pse shoqëritë demokratike kontrollojnë shërbimet e tyre të inteligjencës?	31
Cilat institucione kontrollojnë dhe/ose mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës?	32

Menaxhimi i brendshëm	32
Çfarë roli luan menaxhimi i brendshëm në kontrollimin e shërbimeve të inteligjencës?	32
Kujt i raportojnë shërbimet e inteligjencës?	32
Kush emëron drejtorët e shërbimeve të inteligjencës?	32
Pse drejtorët e shërbimeve të inteligjencës emërohen për një periudhë të caktuar?	33
Ekzekutivi	33
Çfarë roli luan ekzekutivi në kontrollimin e shërbimeve të inteligjencës?	33
Gjyqësori	33
Cili është roli i gjyqësorit në kontrollimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës?	33
Parlamenti	34
Cili është roli i parlamentit në kontrollimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës?	34
Organet profesionale të mbikëqyrjes	34
Cili është roli i organeve eksperte të mbikëqyrjes së inteligjencës?	34
Studim i thellë i organeve parlamentare dhe eksperte të mbikëqyrjes së inteligjencës	38
Cilat aspekte të punës së shërbimeve të inteligjencës mbikëqyren nga organet parlamentare dhe/ose eksperte të mbikëqyrjes?	38
Cilat fuqi ligjore posedohen nga organet mbikëqyrëse?	38
Pse kanë nevojë për resurse financiare dhe njerëzore organet e mbikëqyrjes?	39
Si monitorohen shërbimet e inteligjencës nga mbikëqyrësit?	39
Si raportojnë organet mbikëqyrëse mbi aktivitetet e tyre?	40
Pse janë të rëndësishme raportet publike?	40
A ka konflikt mes të drejtës për të ditur dhe nevojës për fshehtësinë e informatave?	40
Si mund të përputhen nevojat për informata të organeve të mbikëqyrjes dhe shërbimeve inteligjente?	40
Pse është e rëndësishme marrëdhënia mes shërbimeve të inteligjencës dhe organeve të mbikëqyrjes?	41
Si e sigurojnë shoqëritë demokratike pavarësinë e organeve mbikëqyrëse të inteligjencës?	41
Si mund të sigurohet pavarësia e anëtarëve të organeve të mbikëqyrëse?	42
Cilat janë përparësitë e organeve mbikëqyrëse parlamentare?	42
Cilat janë përparësitë e organeve eksperte mbikëqyrëse?	42

Ankesat ndaj shërbimeve të inteligjencës	43
Si mund të ankohen njerëzit për shërbimet inteligjente?	43
Cilat institucione shqyrtojnë ankesat për shërbimet inteligjente?	45
Pse disa shtete njoftojnë njerëzit kur kompetencat e veçanta janë përdorur ndaj tyre?	45
Çfarë e bën një organ shqyrtues të ankesave efektiv?	46
Për lexim të mëtutjeshëm	47
Fund-notat	48

Lista e tabelave dhe kutiave

Tabela 1:	Shembuj të mandateve dhe funksioneve të shërbimeve të inteligjencës	12
Tabela 2:	Krahasimi mes organeve të zgjedhura të mbikëqyrjes së inteligjencës në Belgjikë, Kanada, Afrikë të Jugut dhe Mbretëri të Bashkuar	35
Kutia 1:	Dispozitat kushtetuese jugafrikane për shërbimet e inteligjencës dhe siguri	13
Kutia 2:	Ekstrakt nga Neni 3 i përbashkët i Konventave të Gjenevës	16
Kutia 3:	Procesi i autorizimit të ushtrimit të kompetencave të veçanta nga Shërbimi Kanadez i Sigurisë dhe Inteligjencës	20
Kutia 4:	Rregullat mbi shfrytëzimin e të dhënave personale nga Zyra Federale Gjermane për Mbrojtjen e Kushtetutës	23
Kutia 5:	Ligji gjerman mbi qasjen në të dhëna personale të mbajtura nga shërbimet e inteligjencës	24
Kutia 6:	Rregullat kroate mbi bashkëpunimin e inteligjencës me subjekte të huaja	27
Kutia 7:	Standardet ndërkombëtare të arrestit dhe mbajtjes	29
Kutia 8:	Standardet ndërkombëtare të përdorimit të forcës nga zyrtarët publikë	31
Kutia 9:	Shqyrtimi i ankesave nga Komiteti i Shqyrtimit të Ankesave për Inteligjencën e Sigurisë Kanadeze (SIRC)	44
Kutia 10:	Ligji gjerman për njoftimin e individëve pas përdorimit të kompetencave speciale ndaj tyre	45

Hyrje në Pakon e Instrumenteve

Ligjvënia për sektorin e sigurisë është detyrë komplekse dhe e vështirë. Shumë ligjvënës ndjekin tendencën e kopjimit të legjislacionit nga vendet tjera. Kjo gjë përshpejton procesin e hartimit, sidomos kur tekstet gjenden në gjuhën e ligjvënësit, por rezultati më i shpeshtë është legjislacioni i dobët sesa i mirë.

Edhe pas amandamentimit, ligjet e kopjuara janë shpesh të vjetruara para se të hyjnë në fuqi. Ata mund të mos jenë më në përputhje me standardet ndërkombëtare, ose mund të mos i përgjigjen më së miri kontekstit vendor politik dhe shoqëror. Ligjet e kopjuara shpesh janë edhe në mospërputhje me ligjet tjera vendore.

Në disa raste, thjesht nuk ka ligje model në rajon për llojin e legjislacionit që kërkohet. Ka qenë rasti në rajonin arab, ku sektori i sigurisë ka filluar së voni të debatohet publikisht. Kështu, është vështirë të gjenden ligje të mira model për policinë demokratike, apo për mbikëqyrjen parlamentare të shërbimeve të inteligjencës.

Pra, nuk është ndonjë befasi që shumë ligjvënës arab janë ndjerë të frustruar, të hutuar apo të mbingarkuar me detyrën e hartimit të legjislacionit për sektorin e sigurisë. Atyre iu është dukur e vështirë të afrohen me normat dhe standardet ndërkombëtare, sepse kishte pak apo aspak burime në gjuhën arabe. Shumë nga ta nuk dinin as ku të kërkonin modele, e shumë ishin gati të dorëzoheshin. Disa eventualisht iu drejtuan DCAF-it për ndihmë.

Ideja e një pakoje praktike të veglave për ligjvënësit në rajonin e Arabisë lindi kur ata që merreshin me këtë sektor filluan të kërkonin një zgjedhje standarde, normash e modelesh në gjuhën arabe, për të hartuar legjislacionin e ri. Ekspertët nga rajoni i Arabisë si dhe DCAF-i vendosën të punojnë bashkë për të krijuar disa instrumente praktike.

Për kë është kjo pako e instrumenteve?

Kjo pako kryesisht i dedikohet atyre që synojnë të krijojnë legjislacion të ri për sektorin e sigurisë, apo të zhvillojnë atë ekzistues. Këtu përfshihen parlamentarët, shërbyesit civilë, ekspertët ligjorë, si dhe organizatat joqeveritare. Pakoja e Instrumenteve mund të jetë e dobishme për zyrtarët e sigurisë, dhe poashtu si pikë reference edhe për

hulumtuesit dhe studentët e interesuar për legjislacionin e sektorit të sigurisë.

Çfarë ka në pako?

Pakaja e Instrumenteve dygjuhëshe përmban një numër dokumentesh në anglisht dhe arabisht, të cilat ofrojnë norma dhe standarde, udhëzime dhe shembuj praktikë të ligjeve modele në fusha të ndryshme të legjislacionit të sektorit të sigurisë.

Botimet në vijim që janë botuar apo janë në përpunim e sipër:

- Legjislacioni për policinë
- Legjislacioni për inteligjencë
- Legjislacioni për drejtësinë ushtarake
- Marrëveshjet mbi statusin e forcave

Botimet në vijim do të shtohen sipas nevojës. Botimet në vijim mund të zgjerohen lehtësisht duke shtuar broshura të reja, në bazë të kërkesave nga rajoni arab.

Për gjendjen më të fundit të publikimeve, vizitoni:

www.dcaf.ch/publications

Cili është qëllimi i kësaj pakoje?

Pakaja e Instrumenteve mëton t'i ndihmojë ligjvënësve në rajonin arab që t'i përgjigjen pritjeve të qytetarëve. Qytetarët arabë kërkojnë shërbime profesionale nga forcat e policisë dhe sigurisë, të cilat duhet të jenë efektive, efikase dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të tyre. Ata kërkojnë që organizatat e policisë dhe sigurisë, si dhe anëtarët e tyre, të respektojnë ligjin dhe normat e të drejtave njerëzore, si dhe të japin llogari për performancën dhe sjelljen e tyre. Pra, pakoja promovon standardet ndërkombëtare në legjislacionin e sektorit të sigurisë, si mbikëqyrja demokratike, qeverisja e mirë dhe transparenca.

Pakoja ofron qasje të lehtë ndaj normave ndërkombëtare, në arabisht dhe anglisht, si dhe shembuj të legjislacionit jashtë rajonit arab. Kjo mundëson krahasimin mes përvojave të ndryshme dhe praktikave.

Literatura e mangët në arabisht për legjislacionin e sektorit të sigurisë ka qenë problem i madh për ligjvënësit arabë.

Pakoja e Instrumenteve synon të adresojë këtë mangësi. Një prej qëllimeve të saj është të shkurtojë kohën që ligjvënësit shpenzojnë në kërkim të informatave, duke i mundësuar kështu atyre të përqendrohen në detyrën e tyre kryesore. Sa më shumë informata që vihen në dispozicion në arabisht, aq më shumë qytetarë dhe grupe të shoqërisë civile do ta kenë më të lehtë të artikulojnë

vizionin e tyre mbi llojin e policisë dhe shërbimeve të sigurisë që ata kërkojnë, si dhe që të kontribuojnë në zhvillimin e kornizës moderne dhe të fuqishme ligjore për sektorin e sigurisë.

Pse është me rëndësi ekzistenca e një kornize të fuqishme ligjore për sektorin e sigurisë?

Korniza e shëndoshë ligjore është parakusht për qeverisjen efektive, efikase dhe llogaridhënëse të sektorit të sigurisë sepse:

- Përkufizon rolin dhe misionin e organizatave të ndryshme të sigurisë;
- Përkufizon kompetencat dhe kufizon pushtetin e organizatave të sigurisë e anëtarëve të tyre;
- Përkufizon rolin dhe pushtetin e institucioneve që kontrollojnë dhe mbikëqyrin organizatat e sigurisë;
- Ofron bazën e llogaridhënies, sepse ngre një vijë të qartë mes sjelljeve të ligjshme dhe të paligjshme;
- Fuqizon besimin publik si dhe përforcon legjitimitetin e qeverisë dhe forcave të saj të sigurisë.

Për të gjitha këto arsye, reforma e sektorit të sigurisë shpesh fillon me një shqyrtim të plotë dhe spastrim të legjislacionit vendor të sektorit të sigurisë. Qëllimi është gjetja dhe trajtimi i kontradiktave dhe paqartësive në lidhje me rolet dhe mandatet e institucioneve të ndryshme.

Të kuptuarit e Mbikëqyrjes së Inteligjencës

Cili është qëllimi i këtij udhëzuesi?

Ky udhëzues ofron njohuritë mbi mënyrë sesi shtetet demokratike qeverisin shërbimet e tyre të inteligjencës. Udhëzuesi ilustron mënyrat se si shtetet mund të udhëheqin shërbimet e tyre të inteligjencës në mënyrë që:

- Të kontribuojnë në mënyrë efektive për sigurinë e shtetit dhe popullatës së tyre,
- Të i nënshtrohen kontrollit demokratik,
- të i përgjegjen popullatës së cilës ata i shërbejnë dhe,
- të respektojnë sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut.

Udhëzuesi ofron përgjigje të shkurtra dhe të thjeshta për pyetjet e shpeshta që parashtrihen lidhur me aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës, si dhe kontrollin e mbikëqyrjes e këtyre organizatave. Udhëzuesi pasqyron gjerësisht ligjet, modelet dhe praktikën institucionale të një numri të madh të shteteve demokratike.

Ky udhëzues gjithashtu paraqet faktin që shtetet demokratike dallojnë në qasjet e tyre në organizimin, përcaktimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të tyre të inteligjencës. Nuk ekziston një qasje apo metodë 'e duhur' megjithatë ekzistojnë praktika të mirëpranuara në shumë shtete demokratike lidhur me aktivitetet dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës dhe ky udhëzues sjellë shumë shembuj nga këto.

Çfarë përmban ky udhëzues?

Udhëzuesi është i ndarë në shtatë seksione. Seksioni i parë përqendrohet në rolin që luajn shërbimet e inteligjencës në shumë shoqëri demokratike.

Seksioni pasues flet më shumë për karakteristikat e kornizave ligjore që rregullojnë shërbimet e inteligjencës. Katër seksione i dedikohen sqarimeve se si shtetet demokratike kontrollojnë aktivitetet e shërbimeve të tyre të inteligjencës në mbledhjen e informacioneve, përdorimin dhe menaxhimin e të dhënave personale dhe bashkëpunimin ndërkom-

bëtar. Pjesa e fundit e këtij udhëzuesi përqendrohet në kontrollin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve inteligjente nga organet ekzekutive, parlamentare, gjyqësore dhe eksperte të mbikëqyrjes.

Për kë është udhëzuesi?

Ky udhëzues është për personat e interesuar në qeverisjen e shërbimeve të inteligjencës, por që nuk kanë njohuri profesionale për këtë sferë. Më në veçanti, ky udhëzues adreson tre grupe kryesore. Së pari, është për ata që janë të përfshirë në zhvillimin e ligjeve dhe institucioneve për qeverisjen e shërbimeve inteligjente. Këtu përfshihen parlamentarët dhe stafi mbështetës, anëtarët e ekzekutivit, personeli i shërbimeve inteligjente, si dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile.

Së dyti, ky udhëzues është për anëtarët dhe personelin e organeve mbikëqyrëse të sapothemluara. Së fundi, ky udhëzues shpreson të shërbejë nevojave të mësimit dhe studentëve që dëshirojnë të kenë një pasqyrë të përgjithshme të qeverisjes së shërbimeve të inteligjencës.

Materiali në këtë udhëzues është i prezantuar në mënyrë përshkuese, në formën e një sër pyetjesh dhe përgjigjeve të thjeshta. Ky format synon të i ndihmojë palët e përfshira që nuk janë ekspertë në aplikimin dhe përdorimin e materialit për nevojat e tyre.

Çfarë janë shërbimet e inteligjencës?

Ky udhëzues i referohet shërbimeve të inteligjencës si organizata qeveritare, detyrat kryesore të të cilave janë grumbullimi dhe analizimi i informatave në lidhje me sigurinë kombëtare, si dhe shpërndarjen e tyre tek vendim-marrësit. Këto informata zakonisht kanë të bëjnë me kërcënimet ndaj sigurisë ndërkombëtare si terrorizmi, shpërndarja e armëve të shkatërrimit në masë, si dhe spiunazhin e shteteve armiqësore.

Në shumicën e shteteve demokratike, këto detyra kryhen nga një shërbim i specializuar i

inteligjencës mirëpo në disa vende këto detyra kryhen nga një degë e policisë.

Shtetet shpesh i autorizojnë shërbimet e tyre të inteligjencës që të punojnë ekskluzivisht brenda apo jashtë kufijve të shteteve të tyre. Rrjedhimisht, shtetet mund të kenë shërbime të ndryshme të inteligjencës që punojnë brenda apo jashtë kufijve kombëtar. Shtetet tjera autorizojnë një shërbim të vetëm të inteligjencës që të punojnë edhe brenda edhe jashtë kufijve shtetërorë. Përderisa ky udhëzues përqendrohet kryesisht tek shërbimet vendore të inteligjencës, të definuara si shërbime inteligjente që punojnë brenda territorit të shtetit të tyre, parimet bazë për mbikëqyrje dhe kontroll vlejnë njësoj për shërbimet inteligjente që veprojnë jashtë vendit.

Shërbimet inteligjente në një vend demokratik

Cili është roli i shërbimeve civile të inteligjencës në një shoqëri demokratike?

Shërbimet e inteligjencës janë pjesë e rëndësishme e sektorit të sigurisë në një shoqëri demokratike. Funkzioni i tyre parësor është grumbullimi dhe analizimi i informatave për kërcënimet ndaj shtetit dhe popullsisë së tij. Këto shërbime i ofrojnë këto informata qeverisë, duke i mundësuar asaj hartimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë. Megjithatë, nuk është roli i shërbimeve inteligjente të zbatojnë politikën e sigurisë ngase kjo është përgjegjësi e policisë dhe agjencive tjera të zbatimit të ligjit.

Roli i shërbimeve të inteligjencës për grumbullimin e informatave është i kufizuar; hetimet e tyre fokusohen vetëm tek aktivitetet që kërcënojnë sigurinë kombëtare. Kjo bëhet në pajtim me legjislacionin dhe udhëzimet politike të qeverisë. Shoqëria e jo shërbimet inteligjente përcaktojnë se çfarë përbën kërcënim për sigurinë kombëtare. Ky zakonisht është një proces i gjatë, i cili rezulton në formulimin e një ligji apo politike të sigurisë kombëtare.

Përveç rolit në grumbullimin e informatave, shërbimet inteligjente kryejnë edhe detyra tjera. Për shembull, ato kryejnë edhe veprimtari të kundërzbulimit. Këto veprimtari përfshijnë zbulimin dhe pengimin e spiunazhit të shërbimeve të huaja inteligjente të cilat bëhen kundër interesave të shtetit dhe popullsisë së tyre. Përveç kësaj, shërbimet e inteligjencës janë shpesh përgjegjëse për mbrojtjen e informatave dhe sistemeve informative të shtetit. Për shembull, ato intervistojnë aplikantët për pozita në qeveri që kanë

qasje në informata të fshehta (shih Tabelën 1 për hollësitë e autorizimeve dhe funksioneve të shërbimeve të përzgjedhura të inteligjencës).

Roli i shërbimeve të inteligjencës është thelbësor për mbrojtjen e shtetit dhe popullsisë së tij. Ligji vendor i ndalon shërbimet e inteligjencës që të promovojnë apo mbrojtjen e interesave të veçanta të grupeve të caktuara fetare, etnike apo tjera. Ato duhet të mbesin të paanshme në rolin e tyre në mënyrë që t'i shërbejnë gjithë individëve në shoqëri. Me parandalimin e terrorizmit dhe kërcënimeve tjera ndaj sigurisë kombëtare, shërbimet e inteligjencës kontribuojnë në sigurinë dhe mirëqenien e gjithë individëve në shoqëri.

Cili është roli i shërbimeve ushtarake të inteligjencës?

Shërbimet e inteligjencës ushtarake apo të mbrojtjes janë pjesë e forcave të armatosura. Në shoqëritë demokratike, mandatet e tyre janë edhe më të kufizuara se sa ato të shërbimeve civile të inteligjencës. Ato kryesisht janë përgjegjëse për grumbullimin dhe analizimin e informatave për kërcënimet ndaj personelit dhe bazave të forcave të armatosura, si dhe për këmbimin e atyre informatave me komandën e lartë ushtarake dhe udhëheqësinë politike. Kërcënimet potenciale të cilat shërbimet ushtarake të inteligjencës duhet të monitorojnë mund të paraqiten brenda forcave të armatosura, grupeve vendore, apo nga shtetet dhe subjektet e huaja. Në shumë shtete, shërbimet ushtarake të inteligjencës marrin përsipër edhe detyrën e mbrojtjes së informatave ushtarake të ndjeshme dhe sistemeve të komunikimit. Shërbimet e inteligjencës ushtarake mund të veprojnë brenda edhe jashtë vendit, varësisht nga nevojat e vendit, legjislacionit të tij si dhe zbarkimit të forcave të tij.

Shoqëritë demokratike nuk iu lejojnë shërbimeve të tyre inteligjente ushtarake që të grumbullojnë informata për kërcënimet ndaj sigurisë që nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen. Grumbullimi i informatave mbi kërcënimet jo-ushtarake është përgjegjësi e shërbimeve civile inteligjente. Pra, shërbimet ushtarake inteligjente normalisht nuk lejohen të grumbullojnë informata lidhur me civilët në shtetet e tyre. Në shumë shtete, ligjet obligojnë shërbimet ushtarake të inteligjencës që të thërrasin shërbimin civil inteligjent nëse kanë nevojë të marrin informata mbi kërcënimet ndaj forcave të armatosura nga civilët. Ky kufizim është i vendosur për t'i parandaluar forcat e armatosura që të ndërhyjnë në çështje civile.

Tabela 1: Shembuj të mandateve dhe funksioneve të shërbimeve inteligjente¹

Vendi	Mandatet dhe funksionet e shërbimeve civile të inteligjencës
Kanada	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimi grumbullon, përmes hetimeve apo ndryshe, deri në masën që është gjithësesi e domosdoshme, si dhe analizon e ruan informata në lidhje me aktivitetet që mundën, në baza të arsyeshme, të dyshohen që përbëjnë kërcënime ndaj sigurisë së Kanadasë, si dhe në lidhje me to, i raporton dhe këshillon Qeverisë së Kanadasë. • Shërbimi mund të bëjë edhe vlerësime të sigurisë për departamente të Qeverisë së Kanadasë. • Shërbimi mundet: <ol style="list-style-type: none"> a. të këshillojë cilindo nga ministrat e Kurorës mbi çështjet në lidhje me sigurinë e Kanadasë, apo b. t'i ofrojë secilit ministër të Kurorës informata në lidhje me çështjet e sigurisë apo veprimet kriminale që kanë të bëjnë me ushtrimin e pushtetit apo kryerjen e detyrës apo funksionit të atij Ministri, në bazë të Ligjit mbi Shtetësinë, po Ligjin mbi Migrimin dhe Mbrojtjen e Refugjatëve.
Kroacia	<ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimi sistematik, analizimi, përpunimi dhe vlerësimi i informatave me rëndësi për sigurinë kombëtare; • Me qëllim të zbulimit dhe parandalimit të veprimtarive, nga individë apo grupe, të drejtuara kundër qëndrueshmërisë, pavarësisë, integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kroacisë, që synojnë rrënimin e dhunshëm të strukturave të autoritetit shtetëror; që kërcënojnë shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore njerëzore të përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kroacisë, si dhe të rrezikojnë themelet e sistemit ekonomik të Republikës së Kroacisë.
Holanda	<ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e hetimeve në lidhje me organizatat dhe personat, të cilët për shkak të objektivave që ndjekin, apo përmes aktiviteteve të tyre, përbëjnë bazë për dyshime serioze me rrezikshmëri për ekzistencën e vazhdueshme të sistemit ligjor demokratik, apo ndaj sigurisë apo interesave tjerë vitale të shtetit. • Kryerja e verifikimit të sigurisë sipas Ligjit për Verifikimin e Sigurisë; • Promovimi i masave [...] për mbrojtjen e informatave të cilat duhet të mbesin sekrete për arsye të sigurisë kombëtare, si dhe informatat në lidhje me ato pjesë të shërbimit publik dhe komunitetit afarist që, sipas mendimit të Ministrave përkatës, janë të rëndësishme jetike për vazhdimësinë e rendit social; • Kryerja e hetimeve në lidhje me vendet tjera për temat e përcaktuara nga Kryeministri, Ministri i Punëve të Përgjithshme, në pajtim me ministrat përkatës.

Korniza ligjore për shërbimet e inteligjencës

Si e sigurojnë shoqëritë demokratike bazën ligjore për shërbimet e inteligjencës?

Disa shtete demokratike përfshijnë dispozita të përgjithshme për shërbimet inteligjente në kushtetutat e tyre. Këto norma kushtetuese normalisht janë të përgjithshme, si kërkesat që shërbimet e inteligjencës të jenë llogaridhënese ndaj parlamentit dhe respektimi i sundimit të ligjit (shih Kutinë 1 për dispozitat kushtetuese jugafrikane për shërbimet inteligjente dhe të sigurisë).

Shumica e shteteve demokratike kanë ligje të veçanta për shërbimet e inteligjencës të cilat krijojnë bazën primare ligjore për rregullimin e aktiviteteve të inteligjencës. Ligjet për privacinë, mbrojtjen e të dhënave, sigurinë e informatave, si dhe qasjen ndaj informatave, përmbajnë edhe rregulloret të rëndësishme për shërbimet e inteligjencës. Përveç këtyre, ekzekutivi mund të lëshojë edhe “urdhëra ekzekutivë” apo “direktiva” si dhe rregulla tjera që plotësojnë legjisllacionin. Rregulloret e tilla gjithmonë bazohen në legjisllacionin ekzistues dhe rrjedhimisht duhet të jenë në pajtim me të.

Pse shërbimet e inteligjencës duhet të kenë bazë ligjore?

Shoqëritë demokratike sigurojnë që shërbimet e inteligjencës të veprojnë në pajtim me ligjet kombëtare. Baza ligjore e shërbimeve të inteligjencës është e rëndësishme për katër arsye.

Së pari, ligji definon qartë mandatin, rolin dhe përgjegjësitë e shërbimeve të inteligjencës dhe zyrtarëve të tyre. Ligjet gjithashtu definojnë vepërimtaritë që ata lejohen t’i ndërmarrin. Qeveritë varen në ligj për të kontrolluar shërbimet e inteligjencës.

Së dyti, baza ligjore për të gjitha organizatat e qeverisë është thelbësore në promovimin e transparencës. Ligjet publike e bëjnë shoqërinë të vetëdijshme për funksionet dhe pushtetin e shërbimeve të inteligjencës në qeveri. Shërbimet e inteligjencës kanë bazën ligjore për mbajtjen e kompetencave speciale për të grumbulluar informata që nuk janë në dispozicion të agjencive qeveritare apo individëve privatë. Për shembull, ligjet mund t’i lejojnë atyre të ndërmarrin masa të veçanta për hetimin e individëve. Individët duhet të dijnë se si shërbimet e inteligjencës mund të ndikojnë në jetën e tyre personale si dhe nëse zyrtarët e inteligjencës respektojnë të drejtat individuale sipas ligjit.

Kutia 1: Dispozitat kushtetuese jugafrikane mbi shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë²

Kushtetuta e Republikës së Afrikës Jugore përmban një numër dispozitash të përgjithshme për shërbimet e sigurisë dhe inteligjencës.

- Siguria kombëtare duhet përcjellur në pajtim me ligjin, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare.
- Siguria kombëtare është subjekt i autoritetit të Parlamentit dhe ekzekutivit të vendit.
- Shërbimet e sigurisë duhen strukturuar dhe rregulluar me ligje vendore.
- Shërbimet e sigurisë duhet të veprojnë si dhe duhet t’i mësojnë dhe t’i kërkojnë anëtarëve të tyre të performojnë në pajtim me kushtetutën dhe ligjet, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare zakonore dhe marrëveshjet ndërkombëtare që obligojnë Republikën.
- As shërbimet e sigurisë, e as anëtarët e tyre, nuk mundën që në kryerje të funksioneve të tyre
 - a. të paragjykojnë interesat e një partie politike që janë legjitime në prizmin e Kushtetutës; ose
 - b. më tutje, të masin në mënyrë partiake, interesat e ndonjë partie politike.
- Për të siguruar efektin e parimeve të transparencës dhe llogaridhënies, komisionet shumë-partiake parlamentare do të ushtrojnë mbikëqyrje mbi të gjitha shërbimet e sigurisë, në një mënyrë të përcaktuar nga legjisllacioni vendor, apo rregullat dhe urdhëzimet e Parlamentit.
- Legjisllacioni vendor duhet të rregullojë objektet, kompetencat dhe funksionet e shërbimeve të inteligjencës.

Së treti, baza ligjore i jep shërbimeve të inteligjencës legjitimitet në sytë e opinionit. Një ligj i shpallur publikisht promovon kuptimin e roleve të shërbimeve të inteligjencës, si dhe pse ato kanë nevojë për para publike në kryerjen e këtyre detyrave. Kjo mund të ndihmojë në sigurimin e mbështetjes publike për shërbimet e inteligjencës.

Përfundimisht, ligjet e hapura të inteligjencës nevojiten për të mbajtur qeverinë para përgjegjësisë. Organet e mbikëqyrjes së inteligjencës dhe publiku në përgjithësi i mbajnë ekzekutivin dhe shërbimet e inteligjencës llogaridhënese për zbatimin e ligjeve të tilla. Ligjet gjithashtu i mundësojnë individëve të kërkojnë drejtësi nëse ata besojnë që shërbimet e inteligjencës kanë kryer veprime të paligjshme kundër tyre.

A janë sekrete ligjet e inteligjencës?

Në shtetet demokratike, ligjet themelore që rregullojnë shërbimet e inteligjencës janë në domenin publik. Siç është diskutuar në faqen 13, publiku ka nevojë të dijë se cilat janë rolet e shërbimeve të inteligjencës, si dhe çfarë pushteti kanë ato për kryerjen e atyre detyrave. Publiku gjithashtu duhet të dijë se kur dhe në çfarë kushtesh do të lejohej kufizimi i të drejtave e individit nga shërbimet e inteligjencës, për qëllime të sigurisë kombëtare. Pra, autoriteti i shërbimeve inteligjente për kufizimin e të drejtave të njeriut duhet të rregullohet në ligjet e hapura për publikun.

Megjithatë, qeveria mund të hartojë “akte nënligjore” siç janë “rregulloret” dhe “udhëzimet ministrore” – të cilat nuk mund të qasen nga publiku. Ligji autorizon qeverinë që të lëshojë akte të tilla kur ajo beson që vënia në dispozicion të publikut të disa informatave mund të rrezikojë punën e shërbimeve të inteligjencës, apo sigurinë kombëtare në përgjithësi. Rregulloret që nuk bëhen publike zakonisht përmbajnë informata mbi metodat operative të shërbimeve të inteligjencës, si përdorimi i mjeteve apo teknologjive të caktuara. Informatat e tilla shpesh nuk bëhen publike sepse do të mund t’iu jepnin personave njohuri që i mundëson atyre të shmangin zbulimin nga ato shërbime apo do të mund të zbulonin personat që punojnë për ato shërbime. Këto gjëra mund të dëmtojnë efektshmërinë e shërbimeve të inteligjencës, të jenë kërcënim për sigurinë e personave që punojnë për to, si dhe mund të rrezikojnë përfundimisht sigurinë kombëtare.

Rregulloret që nuk bëhen publike gjithsesi duhet të jenë në përputhje me ligjet ekzistuese publike dhe

Kushtetutën. Për shembull, ato nuk mund të autorizojnë shërbimet e inteligjencës që të ndërmarrin veprime duke shkelur të drejtat e njeriut që parashi-het në të drejtën ndërkombëtare.

Çfarë mbulojnë ligjet për shërbimet e inteligjencës?

Ligjet për shërbimet e inteligjencës i mundësojnë shteteve që të rregullojnë dhe mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës. Këto ligje mbulojnë fushat si në vijim:

Së pari, ligjet përkufizojnë mandatin e shërbimeve të inteligjencës dhe ofrojnë një listë gjithëpërfshirëse të detyrave të tyre. Mandati normalisht përmban përkufizime mbi atë se çfarë përbën kërcënim për sigurinë kombëtare. Këto ligje kufizojnë rolin e shërbimeve të inteligjencës, për të parandaluar zyrtarët e inteligjencës në promovimin e interesave tjerë përkundër atyre të shtetit dhe popullsisë së saj.

Së dyti, ligjet për shërbimet e inteligjencës ofrojnë një listë gjithëpërfshirëse të kompetencave të shërbimeve të inteligjencës, si dhe përkufizojnë se si këto kompetenca mund të ushtrohen. Ligjet i lejojnë shërbimeve inteligjente që të përdorin ato pushtete vetëm në kontekstin e mandatit të tyre. Ato kufizojnë përdorimin e kompetencave për qëllime të sigurisë kombëtare të cilat mund të çojnë në kufizimin e të drejtave individuale.

Së treti, ligjet për shërbimet e inteligjencës përshkruajnë strukturën dhe përbërjen e shërbimeve të inteligjencës, duke përfshirë edhe përgjegjësitë organizative të divizioneve brenda shërbimeve.

Së katërti, ligjet për shërbimet e inteligjencës përkufizojnë se si subjektet qeveritare dhe joqeveritare mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës. Për shembull, ato rregullojnë procesin e emërimit të menaxherëve të lartë të inteligjencës, si dhe përcaktojnë mandatet dhe fuqitë e organeve parlamentare dhe organeve mbikëqyrëse profesionale.

Së pesti, ligjet e inteligjencës përshkruajnë raportet profesionale që shërbimet e inteligjencës kanë me organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare. Për shembull, ligjet përshkruajnë proceset që përdoren nga shërbimet e inteligjencës për të këmbyer informata apo për të kryer operacione të përbashkëta me organizatat tjera.

Së gjashti, ligjet e inteligjencës shpesh ofrojnë rregullat që rregullojnë përdorimin e të dhënave personale nga shërbimet e inteligjencës (shih faqet 21-25).

Përfundimisht, ligjet e inteligjencës përshkruajnë proceset që përdoren nga individët për të parashtruar ankesa ndaj veprimeve të shërbimeve të inteligjencës që janë ndërmarrë kundër tyre (shih faqet 43-46).

Si e sigurojnë shtetet demokratike zbatimin e ligjit nga shërbimet e inteligjencës?

Inteligjente, si gjitha agjencitë tjera qeveritare, janë të obliguara të respektojnë ligjin vendor dhe ndërkombëtar. Me rëndësi të veçantë janë dispozitat e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Ligji vendor i shtetit mbi shërbimet e inteligjencës duhet të jetë në përputhje me obligimet e veta nga e drejta ndërkombëtare.

Gjitha shërbimet e inteligjencës dhe personeli i tyre janë të obliguar të respektojnë ligjin. Ekzekutivi gjithashtu duhet të veprojë në pajtim me ligjin. Autoritetet politike nuk lejohen të japin urdhra për shërbimet inteligjente që kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve të paligjshme.

Anëtarët e ekzekutivit janë ligjërisht përgjegjës për direktivat që i japin shërbimeve të inteligjencës. Punëtorët e shërbimeve të inteligjencës janë individualisht përgjegjës për të siguruar që veprimet e tyre të jenë në përputhje me ligjin. Në shumë shtete, ligji jo vetëm që i obligon ata të sigurojnë se veprimet e tyre janë në përputhje me ligjin, por edhe që të mos zbatojnë urdhrat që shkelin ligjin vendor apo ndërkombëtar. Kështu, anëtari i një shërbimi inteligjent do të duhej të përgjigjej për sjelljen e tij të paligjshme dhe mund të përndjeket penalisht, edhe nëse një veprim i tillë është urdhëruar nga eprori. Duke marrë parasysh kompetencat e gjera që i jepen anëtarëve të shërbimeve të inteligjencës, përgjegjësia e tillë individuale është veçanërisht e rëndësishme si masë mbrojtëse kundër krimeve të rënda, duke përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut, si tortura dhe vrasjet jashtë-gjyqësore.

Kështu, është shumë e rëndësishme që gjyqësori t'i mbajë përgjegjës zyrtarët e inteligjencës, ndërsa nëse ka nevojë, edhe anëtarët e ekzekutivit, sipas ligjit. Vendimet dhe veprimet e tyre individuale mund të sfidohen në gjykatë; vendimet e gjykatës janë obligative për ekzekutivin si dhe për shërbimet e inteligjencës dhe personelin e tyre.

Cilët janë standardet ligjore ndërkombëtare në lidhje me shërbimet e inteligjencës?

Si institucion i shtetit, shërbimet e inteligjencës duhet të zbatojnë obligimet ligjore ndërkombëtare të qeverisë. Obligimet e shtetit sipas të ligjit

ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, sidomos të drejtat civile dhe politike të përcaktuara me Kartën e OKB-së dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, vlejné edhe për shërbimet e inteligjencës. Këto përfshijnë të drejtat për jetën, lirinë, gjykimin e drejtë, privacinë dhe lirinë e shprehjes dhe përkatësisë.

Më 2009 dhe 2010, OKB-ja ka shqyrtuar standardet ekzistuese ligjore ndërkombëtare dhe kontrollet institucionale që zbatohen për shërbimet e inteligjencës. Këshilli i OKB-së për të Drejta të Njeriut ka urdhëruar një studim të praktikave të mira të kornizave ligjore dhe institucionale për shërbimet e inteligjencës si dhe mbikëqyrjes së tyre. Ky studim kishte përpiluar 35 praktika të vlefshme ndërkombëtare dhe u prezantua para Këshillit për të Drejta të Njeriut në qershor të vitit 2010 (shih listën e referencave).

A lejohen shërbimet e inteligjencës të shkelin të drejtat e njeriut?

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk i lejon shteteve (e as shërbimeve të tyre të inteligjencës) të shkelin të drejtat e njeriut të askujt në juridiksionin e tyre. Ngjashëm me agjencitë tjera qeveritare, shërbimet e inteligjencës duhet të jenë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare humanitare. Shtetet sigurojnë që këto standarde ligjore ndërkombëtare të zbatohen në ligjin e tyre të vendit.

Ligji ndërkombëtar për të drejta të njeriut vendos tri kategori të të drejtave dhe lirive të njeriut:

- (1) Të drejtat që nuk mund të kufizohen e as të shmangen në asnjë rrethanë;
- (2) Të drejtat që mund të kufizohen për arsye specifike si dhe në pajtim me kritere rreptësisht ligjore;
- (3) Të drejtat që mund të pezullohen apo kufizohen gjatë një konflikti të armatosur apo gjendjeje të jashtëzakonshme e cila rrezikon ekzistencën e shtetit.

1. Prava koja nikada ne mogu biti ograničena ili od kojih se ne može odstupiti

Ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i ndalon shteteve dhe agjencive të tyre të kufizojnë apo t'i shmangen disa të drejtave njerëzore, në secilën rrethanë. Këto përfshijnë të drejtën për jetë, lirinë nga tortura dhe trajtimet tjera çnjerëzuese apo degraduese, të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën e njohjes para ligjit, lirinë nga skllavërimi dhe shërbesa e pavullnetshme si dhe ndalimi i kidnapimit dhe mbajtjes së paligjshme³. Ligji

ndërkombëtar humanitar plotëson dhe përforcon këto ndalime në periudhat e konfliktit të armatosur; neni 3 i përbashkët i Konventave të Gjenevës thekson këto standarde minimale (shih Kutinë 2).

Shërbimet e inteligjencës nuk lejohen të ndërmarin veprime që shkelin këto të drejta në asnjë periudhë kohore.

Katrori 2: Ekstrakt nga Neni 3 i përbashkët i Konventave të Gjenevës⁴

Në rast të konfliktit të armatosur që nuk ka karakter ndërkombëtar [...] secila Palë në konflikt është e obliguar të zbatojë, si minimum, dispozitat në vijim:

1. Personat që nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në armiqësi, duke përfshirë anëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët e tyre dhe ata që shpallen "plaçkë lufte" për shkak të sëmundjes, plagës, burgimit apo arsyeve tjera, do të trajtohen në mënyrë humane në secilën rrethanë, pa asnjë dallim negativ në bazë race, ngjyre, feje apo besimi, gjinie, lindjeje apo pasurie, apo kritere tjera të ngjashme. Në këtë kuptim, veprat në vijim janë dhe do të mbesin të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend, në lidhje me personat e lartpërmendur:
 - a. dhuna ndaj jetës dhe personit, sidomos vrasjet e gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimet e vrazhda dhe tortura;
 - b. mbajtja e pengjeve;
 - c. nëpërkëmbje e dinjitetit personal, sidomos trajtimet poshtëruese dhe degraduese;
 - d. vendosja e dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa gjykim paraprak të shpallur nga një gjykatë e rregullt, që ofron të gjitha garancitë gjyqësore të cilat njihen si të pashmangshme nga popujt e civilizuar.

2. Të drejtat e njeriut që mund të kufizohen

E drejta ndërkombëtare për të drejta të njeriut i lejon shteteve të kufizojnë disa të drejta dhe liri njerëzore të personave të caktuar. Këto përfshijnë të drejtën për liri dhe privaci si dhe liritë e lëvizjes, grumbullimit dhe shprehjes. Shtetet mund të ndërmarin vetëm masa që kufizojnë ushtrimin e të drejtave nëse ato masa respektojnë kriteret në vijim:

1. Në bazë të një ligji që është publik;
2. Zbatojnë një qëllim legjitim (si mbrojtja e sigurisë kombëtare, siguria publike apo të drejtat dhe liritë e njeriut të tjerëve);
3. Janë të domosdoshme në shoqëri demokratike;
4. Janë në proporcion me qëllimet e deklaruar;
5. Janë në përputhje me obligimet tjera për të drejtat e njeriut. Shtetet shkelin të drejtat e njeriut në fjalë nëse dështojnë të zbatojnë këto kërkesa.

Në shumë shtete, ligji autorizon shërbimet e inteligjencës të kufizojnë të drejtën në privaci, duke i dhënë atyre kompetenca të veçanta për të grumbulluar informata rreth/për individët apo grupet e dyshuara që jenë të përfshirë në aktivitete specifike që kërcënojnë sigurinë kombëtare, sigurinë publike dhe të drejtat e njeriut (shih faqet 17-18). Këto kompetenca speciale përfshijnë masat si monitorimi i komunikimeve të personit pa njohurinë e tyre apo filmimi sekret i aktiviteteve të tyre. Disa shtete gjithashtu i japin mandat shërbimeve të tyre inteligjente që të kryejnë funksione të zbatimit të ligjit (shih faqen 28). Në këtë kontekst, ligji kombëtar iu jep atyre fuqinë të arrestojnë dhe të mbajnë persona të dyshuar të kenë kryer krime specifike.

Këto fuqi kufizojnë të drejtën ndaj lirisë dhe lirinë e lëvizjes.

Shtetet demokratike vendosin kontrolle strikte mbi shërbimet e tyre inteligjente në përdorimin e pushtetit të tyre, për të siguruar respektimin e standardeve ndërkombëtare. Ato sigurojnë që pushteti i tyre të rregullohet me ligj, të autorizohen dhe mbikëqyren nga institucionet jashtë shërbimeve të inteligjencës (shih faqet 19-21).

Shmangia nga obligimet për të drejtat e njeriut gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

Ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lejojnë përkohësisht reduktimin e obligimeve ndaj të drejtave të njeriut gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Shteti mund të shpall gjendje të jashtëzakonshme në rrethana të jashtëzakonshme në rast të kërcënimit të 'mirëqënies së shtetit'. Kjo përfshin kërcënimet e menjëhershme dhe serioze për sigurinë fizike të popullatës dhe/apo funksionimin e institucioneve demokratike⁵. Vendimin për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme dhe shmangien nga disa të drejta specifike merret nga ekzekutivi. Shërbimet e inteligjencës nuk janë të involuara në këtë proces. Pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, shteti duhet të i njoftojë organet relevante dhe të specifikojë se cilat të drejta të njeriut do të jenë të suspenduara apo të kufizuara. Suspendimet apo kufizimet e të drejtave specifike duhet të jenë të përkohshme, të ndërlidhura me gjendjen emergjente dhe në proporcion me kërcënimin e shfaqur. Përveç kësaj, çdo suspendim dhe kufizim i të drejtave duhet të shqyrtohen nga gjyqësori dhe parlamenti.

Shteteve nuk u lejohej të heqin të drejtat e patjetrueshme që përmbajnë marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Së këndejmi, dispozitat nacionale kushtetuese për kompetencat gjatë gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të përdoren për të arsyetuar veprimet të cilat cenojnë ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Nëse shërbimet e inteligjencës marrin kompetenca shtesë për të kufizuar të drejtat e njeriut në gjendje të jashtëzakonshme, ata duhet të vazhdojnë së respektuari të drejtën ndërkombëtare dhe vendore për të drejtat e njeriut.

Aktivitetet e tyre duhet të jenë nën kontroll dhe nën mbikëqyrjen e ekzekutivit, parlamentit dhe gjyqësorit, apo ndonjë organi tjetër ekzistues profesional për mbikëqyrje.

Mbledhja e informacionit

Si i mbledhin informacionet shërbimet e inteligjencës

Në shoqëritë demokratike, shërbimet e inteligjencës mbledhin informacionet që ju duhen për të përbushur mandatin e tyre nga burimet publike siç janë artikujt e mediave, raportet nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe botimet akademike.

Shërbimet e inteligjencës gjithashtu mbledhin informacione nga personat që kanë (apo kanë mundur të kenë) qasje në informacionin e duhur. Për shembull, anëtarët e grupit që kërcënojnë sigurinë kombëtare mund të veprojnë edhe si informator duke ia kaluar informacionin shërbimeve të inteligjencës. Shërbimet e inteligjencës mund të përdorin edhe persona me identitete falso për t'u infiltruar në organizata dhe për të dhënë informacione për aktivitetet e tyre.

Individët dhe grupet që planifikojnë të kërcënojnë sigurinë kombëtare nuk shpaleshin qëllimet e tyre. Prandaj shoqëritë demokratike kanë nevojë për legjislacionin i cili u mundëson shërbimeve të inteligjencës që të mbledhin informacione të cilat nuk mund të gjenden në sferën publike. Prandaj legjislacioni i jep shërbimeve të inteligjencës kompetenca të posaçme të cilat zakonisht nuk i kanë në dispozicion anëtarët tjerë të shoqërisë. Këto kompetenca speciale shtrihen në katër fusha kryesore.

Së pari, legjislacioni duhet t'i mundësojë shërbimeve të inteligjencës monitorimin e komunikimit verbal, elektronik apo të dokumenteve të individëve pa miratimin e tyre. Aktivitetet e tilla, kërkojnë mjete të avancuara dhe teknikisht komplekse.

Së dyti, legjislacioni duhet gjithashtu të mundësojë shërbimet e inteligjencës që të xhirojnë dhe të fotografojnë individët dhe pronat e tyre pa miratimin e tyre.

Së treti, legjislacioni duhet të mundësojë shërbimeve të inteligjencës të japin identitete falso agjentëve të vet që të mundën të infiltrohen në grupet të cilat rrezikojnë sigurinë kombëtare.

Dhe në fund, legjislacioni mund të ua lejojë që ata të bëjnë kërkesë zyrtare agjencive qeveritare apo kompanive private për informacione për persona edhe atëherë kur kjo mund të cenojë të drejtën për privaci.

Për shembull, ata mund të lejohen që të kërkojnë regjistrin e thirrjeve telefonike për ndonjë individ nga kompania telefonike.

Çfarë informacionesh u lejohej shërbimeve të inteligjencës të mbledhin?

Në shoqëritë demokratike, ligjet nacionale kontrollojnë informacionet të cilat shërbimet e inteligjencës mund t'ia mbledhin. Ligjet u lejojnë shërbimeve të inteligjencës të mbledhin informacion për ndonjë aktivitet specifik që kërcënon sigurinë kombëtare ashtu siç definohet në mandatin e tyre ligjor. Atyre u lejohej që të mbledhin informacione për individët dhe grupet e involuara në aktivitete të tilla, nëse informacioni është relevant dhe i domosdoshëm për kryerjen e mandatit të tyre.

Cilat informacione nuk u lejohet të mbledhin shërbimeve të inteligjencës?

Ligjet për inteligjencën kufizojnë llojet e informacioneve që zyrtarët mund t'i mbledhin. Së pari, ligjet ua ndalojnë marrjen e informacionit për individët dhe aktivitetet e tyre të cilat nuk paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare.

Së dyti, në shoqëritë demokratike ligjet zakonisht u ndalojnë zyrtarëve të inteligjencës që të mbledhin informacione për aktivitetet e ligjshme shoqërore dhe politike. Për shembull atyre nuk u lejohet marrja e informatave për aktivitetet e ligjshme të partive politike dhe anëtarëve të tyre për grupet e involvuara në protesta paqësore. Këto ndalesa ligjore mbrojnë të drejtat e njeriut dhe vlerat tjera që shoqëritë demokratike i konsiderojnë të rëndësishme siç është liria e asociimit dhe bashkimit.

Përfundimisht ligjet zakonisht i ndalojnë zyrtarët e inteligjencës që të mbledhin informacionin i cili promovon interesa të veçanta. Për shembull ligji ua ndalon spiunimin e kundërshtarëve politik të ndonjë partie të veçantë.

Pse shtetet kufizojnë mbledhjen e informacioneve nga profesione të caktuara?

Pjesëtarë të disa profesioneve si gazetarë, parlamentarë, avokatë, klerikë dh mjek mund të kenë informacione që mund të jenë me interes për shërbimet e inteligjencës. Por shumë shoqëri demokratike kanë miratuar ligje dhe kanë ndërmarrë masa për të kufizuar apo parandaluar shërbimet e inteligjencës që të mbledhin informacione nga apo për individë që u takojnë këtyre profesioneve. Për shembull, ligji mund të ndalojë mbledhjen e informacionit nga këta persona, përveç nëse shërbimet e inteligjencës dëshmojnë se ata janë të involvuar direkt në kërcënime serioze për sigurinë kombëtare. Përveç kësaj, shoqëritë demokratike zbatojnë kontrolle speciale për mbledhjen e informacionit për pjesëtarë të profesioneve të caktuara. Disa shtete kërkojnë që shërbimet e inteligjencës të kërkojnë miratim nga kryetari i parlamentit përpara se të hetojnë deputetët e parlamentit.

Shtetet demokratike kufizojnë mbledhjen e informacionit për profesione të caktuara në mënyrë që të mbrojnë shërbimet që ata ua ofrojnë popullatës. Për shembull, avokatët u ndihmojnë të arrestuarve që të ushtrojnë të drejtat e tyre për liri dhe gjykim të drejtë.

Në rast se shërbimet e inteligjencës monitorojnë komunikimin që bëhet në mes avokatit dhe të arrestuarve, me këtë rast ata shkelin të drejtën për qasje konfidenciale me avokatin. Ata hetojnë çështje me interes për publikun dhe bazohen në komunikimin konfidencial për të bërë storiet e tyre. Ky rol është qenësor për mbikëqyrjen e aktiviteteve të agjencive qeveritare dhe zbulimin e keqpërdorimeve. Nëse shërbimet e inteligjencës monitorojnë komunikimin e gazetarëve ata ndërhyjnë negativisht në punën e çmuar të mediave.

Si i kontrollon një shoqëri demokratike përdorimin e kompetencave speciale?

Shtetet bëjnë ligje për t'ju dhënë shërbimeve të inteligjencës kompetenca speciale për të mbledhë informacion për kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë kombëtare. Kompetencat speciale janë masat që nuk janë në dispozicion për agjencitë tjera qeveritare (me përjashtim të disa organeve të policisë) apo pjesëtarëve të popullatës (shih faqen 17)

Shoqëritë demokratike definojnë dhe kufizojnë përdorimin e kompetencave speciale të shërbimeve të inteligjencës përmes ligjeve dhe rregullore të cilat përcaktojnë se:

- Kënd munden apo nuk munden ta hetojnë;
- Çfarë informacioni munden apo nuk munden ta mbledhin;
- Çfarë masash u lejohen të përdorin për të mbledhur informacionin ;
- Kur ju lejohet dhe nuk ju lejohet që të përdorin kompetencat speciale; dhe
- Në çfarë kohëzgjatje u lejohen ato kompetenca të përdoren

Përdorimi i kompetencave speciale të shërbimeve të inteligjencës në shoqëritë demokratike bëhet përmes proceseve dhe organizimeve për autorizim, mbikëqyrje dhe vlerësimin e përdorimit të kompetencave speciale.

Kush autorizon përdorimin e kompetencave speciale?

Në shoqëritë demokratike, përdorimi i kompetencave speciale është më shumë një përjashtim sesa një rregull. Shoqëritë demokratike vendosin kontrolle të rrepta për të minimizuar rreziqet që shoqërojnë përdorimin e tyre. Për këtë arsye sa herë që

shërbimet e inteligjencës duan që të përdorin kompetenca speciale, ato kërkojnë të kenë autorizimin e organit të caktuar të jashtëm (shih Kutinë 3 detajet e këtij procesi në Kanada). Shërbimet e inteligjencës dorëzojnë kërkesën tek organi i caktuar duke arsyetuar nevojën për përdorimin e kompetencave speciale. Organi autorizues do të sigurohet që kjo kërkesë të jetë në përputhje me ligjin.

Zakonisht këtë e bën një anëtar i ekzekutivit, si për shembull një ministër përgjegjës për shërbimet e inteligjencës apo një gjykatë përgjegjëse për autorizimin e përdorimit të kompetencave speciale. Por, gjykata më shumë ka gjasa të caktohet të jetë organ mbikëqyrës për rastet që kanë të bëjnë me ndërhyrje të konsiderueshme në jetët e individëve, siç janë bastisja dhe konfiskimi i pronave e monitorimi i komunikimeve. Gjykatat janë plotësisht të pavarura nga shërbimet e inteligjencës dhe ekzekutivit dhe janë në pozitë që të analizojnë në mënyrë objektive kërkesat për përdorimin e kompetencave speciale.

Disa shtete kërkojnë që të dyja, edhe gjyqësori por edhe ekzekutivi, të autorizojnë përdorimin e kompetencave speciale (shih për shembull modelin e Kanadës tek Kutia 3). Kjo qasje ofron një kontroll shtesë për t'u siguruar që përdorimi i kompetencave speciale është i ligjshëm, i domosdoshëm dhe i vlefshëm në raport me rreziqet.

Si e autorizon shteti përdorimin e kompetencave speciale?

Procesi i autorizimit për përdorimin e kompetencave speciale mes shteteve shpesh varet nga lloji specifik i kompetencës speciale që shërbimi i inteligjencës dëshiron të përdorë. Por rëndom ligjet parashohin tre hapa si në vijim që duhet të ndërmerren nga shërbimet e inteligjencës përpara se të përdorin kompetencat speciale (shih Kutinë 3).

Së pari, një anëtar i caktuar i shërbimeve të inteligjencës shkruan një kërkesë për përdorimin e kompetencave speciale e cila zakonisht përmban:

- Përshkrimin e aktivitetit dhe individin specifik dhe/apo grupet që shërbimet e inteligjencës duan të hetojnë;
- Një sqarim për përpjekjet që i ka ndërmarrë shërbimi i inteligjencës për të mbledhur informacionet dhe se çfarë është arritur në saje të atyre përpjekjeve;

- Metodën speciale që ata duan të përdorin dhe saktësisht çfarë do të bëjnë nëse monitoruesi i thërret në një linjë specifike telefoni;
- dhe arsyetimi për përdorimin e kompetencës speciale, domosdoshmërinë dhe dobinë e përdorimit të tyre për nevoja të hetimit.

Së dyti, organi autorizues shqyrton kërkesën dhe vlerëson si në vijim, nëse:

- Përdorimi i propozuar i kompetencave speciale është në përputhje me të gjitha ligjet përkatëse;
- Përdorimi është i domosdoshëm dhe i dobishëm; dhe
- Përdorimi është proporcional me nivelin e kërcënimit të aktivitetet që po hetohet.

Së treti, organi autorizues lëshon urdhëresën e cila thekson kompetencat speciale që autorizohen dhe sa është kohëzgjatja e përdorimit të atyre kompetencave

Kërkesa dhe procesi i autorizimit të përshkruar si më sipër duhet të dokumentohet në mënyrë që shërbimet e inteligjencës dhe organet mbikëqyrëse të mund të vlerësojnë vendimet e marra.

Si i mbikëqyrin shtetet demokratike përdorimin e kompetencave speciale?

Shërbimet e inteligjencës bëjnë raportime të rregullta organit ekzekutiv dhe/apo atij mbikëqyrës gjatë rrjedhës së operacionit. Ato ofrojnë përmbledhjen e informacioneve të grumbulluara, progresin e arritur dhe problemet me të cilat ballafaqohen. Ky raportim u mundëson mbikëqyrësve të vlerësojnë nëse përdorimi i kompetencave speciale ka qenë ligjor dhe i domosdoshëm në mënyrë që shërbimet e inteligjencës të përmbushin mandatin e tyre.

Organi ekzekutiv dhe/apo mbikëqyrës mund të përfundojë përdorimin e kompetencave speciale nëse shërbimi i inteligjencës nuk ka respektuar ndonjë apo të gjitha kontrollet ligjore për përdorimin e kompetencave speciale, apo nëse ndonjëri nga organet mbikëqyrëse vlerëson që ato kompetenca nuk janë më të nevojshme.

Dhe në fund, organet mbikëqyrëse shqyrtojnë përdorimin e kompetencave speciale pasi ato të kenë përfunduar. Në disa shtete, organet mbikëqyrëse mund të urdhërojnë shërbimet e inteligjencës që të fshijnë informacionet e mbledhura në mënyrë jo të ligjshme. Gjithashtu, organet e jashtme të mbikëqyrjes vlerësojnë përdorimin e kompetencave speciale për të identifikuar trendet që do të mund të ndihmonin qeverinë dhe shërbimet e inteligjencës të adresojnë probleme specifike.

Kutia 3: Procesi i autorizimit për përdorimin e kompetencave speciale nga Shërbimi Kanadez për Inteligjencë⁶

Ligji Kanadez për Shërbimet e Sigurisë dhe Inteligjencës përcakton hapat për aplikim dhe dhënien e urdhëresave për shërbimet e inteligjencës në përdorimin e kompetencave speciale. Çdo aplikim për përdorimin e kompetencave speciale duhet të miratohet nga ekzekutivi dhe një gjykatës.

Aplikimi për urdhëresë

Seksioni 21.

1. Nëse drejtori apo ndonjë i punësuar i caktuar nga Ministri për këtë çështje, beson me arsye që urdhëresa nga kjo dispozitë është e nevojshme për të mundësuar Shërbimit që të hetojë kërcënimin për sigurinë e Kanadës apo të kryej detyrat dhe funksionet sipas dispozitës 16, atëherë drejtori apo nëpunësi, pasi të kenë marrë miratimin nga Ministri, mund të bëjnë aplikimin në përputhje me nënseksionin (2) tek gjykatësi për urdhëresën e cekur në këtë seksion.

Çështjet që duhet specifikuar në aplikacionin për autorizim

2. Aplikacionin për gjykatësin sipas nënseksionit (1) duhet të jetë me shkrim dhe i shoqëruar nga një betim me shkrim të aplikantit për çështjet si në vijim:
 - a. faktet që arsyetojnë mendimin e bazuar në fakte që autorizimi sipas këtij seksioni kërkohet për të mundësuar Shërbimit të hetojë kërcënimin për sigurinë e Kanadës apo që të kryejë detyrat dhe funksionet e veta siç parashihen në seksionin 16;
 - b. që procedurat tjera hetuese janë shterrur apo kanë dështuar, apo nuk kanë gjasa të kenë sukses ose që urgjenca e rastit është e tillë që do të ishte jopraktike të bëhet hetimi me procedura tjera hetuese, apo pa autorizim sipas këtij seksioni, informacioni me rëndësi për kërcënimin e sigurisë së Kanadës apo performanca e detyra dhe funksioneve sipas seksionit 16 paragrafi (a) nuk do të mund të realizohen;
 - c. lloji i komunikimit të propozuar për përgjim, lloji i informacionit, incizimit, dokumentet apo gjërat tjera të propozuara për t'i nxjerrë si dhe kompetencat siç përmenden në paragrafët (3)(a) deri në (c) që propozon të ushtrohen për këtë qëllim;
 - d. identiteti i personit, nëse dihet, komunikimi i kujt propozohet të përgjohet apo kush posedon informacionin, inçizimin, dokumentin apo gjërat e propozuara për t'i nxjerrë;
 - e. personat apo njësitë të personave të cilëve u drejtohet autorizimi;
 - f. një përshkrim i shkurtër mbi vendin kur është propozuar ekzekutimi i autorizimit, nëse mund të ipet përshkrimi i përgjithshëm mbi vendin;
 - g. periudha që nuk i kalon 60 ditë apo një vit, siç mund të ngjajë që autorizimi të jetë në fuqi siç e parasheh nënseksioni (5); dhe
 - h. çdo aplikacion i mëhershëm i kryer për personin në fjalë të identifikohet në betimin me shkrim sipas paragrafit (d), data kur është bërë aplikacioni, emri i gjykatësit të cilit iu është bërë kërkesa dhe vet vendimi i gjykatësit.

Dhënia e autorizimit

3. Duke mos marrë për bazë ndonjë ligj tjetër përveç Ligjit për Statistikat, ku gjykatësit të cilit aplikacioni sipas nën-seksionit (1) ka plotësuar kushtet sipas paragrafëve (2) (a) dhe (b) të përfshira në betimin me shkrim që shoqëron aplikacionin, atëherë gjykatësi mund të lëshojë autorizimin që autorizon personat të përgjojnë komunikimin apo të marrin informacionin, inçizimin, dokumentin apo ndonjë gjë tjetër për këtë qëllim:

- a. të hyjnë në çdo vend, të hapin apo të kenë qasje në çdo gjë;
- b. të hulumtojnë, menjanojnë apo të kthejnë, të ekzaminojnë, të marrin mostra apo të bëjnë kopje të dokumenteve apo të informacionit, inçizimit, dokumentit apo ndonjë gjënë tjetër; ose
- c. të instalojnë, mbajnë apo mënjanonjë ndonjë gjë.

Çështjet që duhet specifikuar në autorizim

4. Në autorizimin e lëshuar sipas nën-seksionit (3) duhet të specifikohet si në vijim
 - a. Lloji i komunikimit që është autorizuar të përgjohet, lloji i informacionit, inçizimit, dokumenteve apo gjërave tjera të autorizuara të nxirren dhe kompetencat që referohen në paragrafët (3) (a) deri tek (c) e që autorizohen të ndërmerren për atë qëllim;
 - b. Identiteti i personit, nëse dihet, komunikimi i kujt po përgjohet apo kush posedon informacionin, inçizimin, dokumentin apo ndonjë gjë tjetër që duhet nxjerrë;
 - c. Personat apo grupet e personave të cilëve iu drejtohet autorizimi;
 - d. Një përshkrim i përgjithshëm për vendin kur do të ekzekutohet autorizimi, nëse një përshkrim i tillë është i mundshëm;
 - e. Periudhën se sa do të jetë në fuqi autorizimi; dhe
 - f. Kushtet dhe obligimet që gjykatësi mund t'i ketë parasysh dhe t'i këshillojë për interesin e përgjithshëm publik.

Përdorimi dhe menaxhimi i të dhënave personale

Çfarë janë të dhënat personale?

Të dhënat personale janë informacionet për një individ të caktuar. Ato përmbajnë fakte siç janë detajet e kontaktit, dita e lindjes, numrat e pasaportës apo sigurimit social. Të dhënat personale përmbajnë edhe informacione tjera më të detajuara për jetën private të një personi, siç janë regjistrat e punësimit dhe shëndetësisë, besimi fetar apo opinionet politike, detajet e anëtarësimit në parti politike dhe sindikata, dhe detaje për marrëdhëniet me partnerët dhe miqtë. Shërbimet e inteligjencës mund të kenë nevojë të mbledhin të dhëna personale për individët për të identifikuar kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë kombëtare.

Si i mbledhin shërbimet e inteligjencës të dhënat personale?

Shërbimet e inteligjencës kërkojnë të dhënat personale në pesë mënyra kryesore. Së pari shërbimet e inteligjencës mbledhin të dhënat nga burimet e hapura dhe publike.

Së dyti, ato marrin të dhënat personale përmes përdorimit të kompetencave speciale siç është monitorimi sekret i komunikimeve (shih faqen 17). Së treti

ato mund të kërkojnë informacionet dhe të dhënat personale për një individ nga agjencia vendore qeveritare siç është shërbimi për imigracion. Së katërti, informatorët ofrojnë të dhëna shërbimeve të inteligjencës. Dhe së fundi, shërbimet e inteligjencës marrin të dhënat personale për individ të caktuar nga qeveritë e huaja dhe/apo shërbimet e tyre të inteligjencës.

Si i përdorin shërbimet e inteligjencës dhe qeveritë e tyre të dhënat personale?

Shërbimet e inteligjencës marrin të dhënat personale që mbledhin në formë elektronike, në letër apo në qasje të lirë. Së pari ata përdorin këto dokumente për të mbështetur hetimet në proces dhe ato të ardhshme për sigurinë kombëtare. Ato mund të përdorin të dhënat personale të individëve që aplikojnë për dëshmitë e sigurisë së qeverisë.

Së dyti, shërbimet e inteligjencës shkëmbejnë të dhënat personale me agjencitë qeveritare dhe zyrtarët siç mund të jenë autoritetet për zbatimin e ligjit dhe prokurorët. Qeveritë kanë shtuar përdorimin e të dhënave personale nga shërbimet e inteligjencës për të mbështetur ndërmarrjen e veprimeve ligjore kundër individëve të caktuar. Ata përdorin të dhënat personale gjatë operacioneve kundër-terrorizmit për të arsyetuar ndalimin e udhëtimit, refuzimin e vizave, konfiskimin e pasurisë dhe kufizimin e lëvizjes si dhe komunikimin me të tjerët.

Në rrethana të jashtëzakonshme, shërbimet e inteligjencës gjithashtu kanë të drejtë të shkëmbejnë të dhëna personale me qeveritë e huaja dhe agjencitë e tyre.

Për më shumë informata, luteni që t'i referoheni seksionit Bashkëpunimi Ndërkombëtar për Inteligjencë në këtë libër udhëzues.

Pse shtetet demokratike e kufizojnë përdorimin e të dhënave personale?

Shtetet demokratike kufizojnë përdorimin e të dhënave personale nga ana e shërbimeve të inteligjencës për tri arsye kryesore. Së pari, shoqëritë demokratike kufizojnë përdorimin e të dhënave personale për shkak të rrezikut që mund t'i kanoset individit zbulimi i të dhënave personale. Të dhënat personale përmbajnë informacionin për aspektin më privat të jetës së personit përfshirë këtu regjistrat mjekësor, besimet fetare, bindjet politike dhe marrëdhëniet personale. Zbulimi i informacionit të tillë mund të prishë shanset e punësimit, marrëdhëniet personale e profesionale si dhe sigurinë personale.

Së dyti, ekziston rreziku potencial që shërbimet e inteligjencës dhe/apo të tjerët që kanë qasje ligjore në të dhënat personale t'i shfrytëzojnë ato për qëllime të paligjshme. Për shembull, shërbimet e inteligjencës dhe/apo ekzekutivi mund të bien në sprovë dhe të përdorin të dhënat personale për të diskredituar apo shantazhuar kundërshtarët politik.

Për këtë arsye qeveritë demokratike duhet të kufizojnë përdorimin e të dhënave personale përmes legjislacionit.

Dhe e fundit, individët nuk e dinë që shërbimet e inteligjencës i mbajnë të dhënat e tyre personale. Dhe kështu ata s'do të mund të sfidonin përdorimin e të dhënave personale të përdorura nga shërbimi i inteligjencës dhe as saktësinë e atyre të dhënave. Prandaj, është qenësore të ketë rregulla të qarta për përdorimin e të dhënave personale dhe që organet mbikëqyrëse të monitorojnë respektimin e këtyre rregullave.

Pse zbatohet kontrolli ligjor në përdorimin e të dhënave personale?

Shërbimet e inteligjencës duhet të mbledhin dhe të shfrytëzojnë të dhëna të caktuara personale për kryerjen e këtyre funksioneve. Në veçanti ata duhet të jenë në gjendje që të identifikojnë individë të caktuar dhe të mbledhin informacion për sjelljet dhe aktivitetet e tyre për të identifikuar kërcënimet për sigurinë kombëtare. Duke pasur këtë parasysh,

shtetet miratojnë ligje që u lejojnë shërbimeve të inteligjencës të përdorin disa të dhëna personale pa pëlqimin e personave të prekur. Përmes legjislacionit ata gjithashtu zbatojnë kontrolle të rrepta për të rregulluar përdorimin e të dhënave personale (shih Kutinë 4 për një shembull të përdorimit të të dhënave personale nga shërbimi i inteligjencës në Gjermani). Këto kontrolle janë komplekse; në vijim diskutohen vetëm tri lloje të kontrolleve ligjore.

Së pari, ligjet nacionale kontrollojnë llojin e të dhënave personale që shërbimet e inteligjencës mund të përdorin. Për shembull ligjet u lejojnë shërbimeve të inteligjencës përdorimin e të dhënave personale të individëve të involvuar në aktivitete që kërcënojnë sigurinë nacionale siç mund të jetë anëtarësimi në ndonjë organizatë terroriste. Ligjet kërkojnë që përdorimi i të dhënave personale të jenë të lidhura me sjelljet e personit; përkatësisht involvimi i tyre në aktivitetet që kërcënojnë sigurinë. Shtetet demokratike ndalojnë shërbimet e inteligjencës në përdorimin e pjesëve nga të dhënat personale që ndërlidhen me karakteristikat si etnicitetit i personave, feja apo gjinia. Për më shumë, ligjet ndalojnë shërbimet inteligjente në përdorimin e pjesëve të të dhënave personale që nuk ndërlidhen me ndonjë kërcënim të sigurisë kombëtare, siç janë të dhënat mjekësore edhe nëqoftë se janë të involvuar në aktivitete për rrezikimin e sigurisë kombëtare.

Së dyti, ligjet vendosin kufizime edhe në ruajtjen e të dhënave personale. Shërbimet e inteligjencës mund të ruajnë të dhënat personale vetëm nëse ato janë të domosdoshme për identifikimin dhe analizimin e një kërcënimi specifik për sigurinë kombëtare. Në shumë shoqëri demokratike ligjet nacionale kërkojnë nga shërbimet e inteligjencës fshirjen e të dhënave personale të individëve që nuk kërcënojnë sigurinë kombëtare.

Së treti, kontrollet ligjore kanë qasje në të dhënat që mbajnë shërbimet e inteligjencës. Vetëm zyrtarë të caktuar mund të kenë qasje në dokumentet për të dhënat personale. Ligji gjithashtu i obligon ata që të dokumentojnë të gjitha qasjet në dokumentacionin me të dhënat personale nga ana e këtyre individëve. Së katërti, ligjet kufizojnë dhënien e këtyre të dhënave personale për përdorim ndonjë agjencie tjetër qeveritare. Ata mund të shkëmbejnë të dhënat vetëm me organet e autorizuara qeveritare që kanë nevojë për informacionin për të ushtruar mandatin e tyre. Kufizime të rrepta janë të vendosura në mënyrën sesi këto organe mund të përdorin të dhënat personale që shkëmbejnë me shërbimet e inteligjencës.

Kush e mbikëqyr përdorimin e të dhënave personale dhe çfarë bëjnë ata?

Organe të jashtme mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës në përdorimin e të dhënave personale që të sigurohen që ata i përdorin ato në përputhje me ligjin. Organe të tilla përfshijnë organet parlamentare dhe organet profesionale për mbikëqyrje si dhe institucionet për mbrojtjen e të dhënave (shih faqet 34-42).

Këto organe mbikëqyrëse vëzhgojnë vendimet e shërbimeve të inteligjencës për ruajtjen e të dhënave personale dhe krijimin e dosjeve për individë të caktuar. Në disa shtete, organi mbikëqyrës duhet të jap pëlqimin për shërbimet e inteligjencës para krijimit të dosjes së një individi.

Organet mbikëqyrëse gjithashtu kontrollojnë dosjet e shërbimeve të inteligjencës për t'u siguruar që

Kutia 4: Rregulloret për përdorimin e të dhënave personale nga Zyra Federale Gjermane për Mbrojtjen e Kushtetutës⁷

Ligji gjerman zbaton kontrole të drepta për përdorimin e të dhënave personale nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës (Shërbimi vendor i Gjermanisë për inteligjencë). Këto dy pjesë nga ligjet gjermane janë shembuj të mirë për praktikat e mira në mbledhjen, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave personale. Në Gjermani të gjitha këto aktivitete monitorohen nga Komisioni G10, një organ i pavarur mbikëqyrës i cili ka qasje në informacionin që mbajnë shërbimet e inteligjencës.

Bazat e lejueshmërisë për përdorimin e të dhënave personale

- Për të përmbushur të dhënat, Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës mund të ruaj, modifikojë dhe të përdorë të dhënat personale nëse:
 1. ekzistojnë tregues aktual për përpjekjet dhe aktivitetet si në seksionin 3, nëseksionin 1 (këto aktivitete përfshijnë: përpjekjet e drejtuara kundër rendit themelor demokratik, ekzistencës apo sigurisë së Federatës apo ndonjëres nga shtetet e saj, apo synon pengimin e organeve kushtetuese e saj që të ushtrojë detyrat e veta)
 2. është e domosdoshme për hetimin dhe analizimin e përpjekjeve apo aktiviteteve sipas seksionit 3, nëseksioni 1 apo
 3. Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës ndërmerr masa sipas Seksionit 3, nëseksionit 2. (përkatësisht kundër aktiviteteve që kërcënojnë sigurinë apo aktivitetet e inteligjencës që zhvillohen në emër të një shteti të huaj)

Rregulloret për ruajtjen, korrigjimin dhe fshirjen e të dhënave personale që mbahen nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës

- Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës kufizonë kohëzgjatjen e ruajtjes (së të dhënave personale) deri atëherë kur ato të jenë të domosdoshme për kryerjen e detyrave të saja.
- Të dhënat e pasakta personale të ruajtura në dosje do të korrigjohen nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës.
- Kur kemi të bëjmë me raste të veçanta, Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës do të kontrollojë gjatë periudhave të caktuara, pas më së shumti pesë viteve nëse ato të dhëna personale të ruajtura duhet korrigjuar apo fshirë.
- Të dhënat personale në dosje do të fshihen nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës nëse ruajtja e tyre ishte e palejueshme apo ato nuk nevojiten më për përmbushjen e detyrave. Të dhënat nuk do të fshihen nëse ka arsye të besohet që fshirja do të dëmtonte interesat legjitime të subjektit të të dhënave. Në këtë rast të dhënat do të bllokohen dhe do të transferohen me miratimin e subjekteve të të dhënave.

Mbikëqyrja

- Kompetencat mbikëqyrëse të Komisionit (G10) do të zgjerohen dhe do të mbulojnë gjithë fushëveprimin e mbledhjes, procedimit dhe përdorimit të të dhënave personale të nxjerra sipas këtij Ligji për shërbimet e inteligjencës së Federatës.

Procedimi i të dhënave personale është në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Ata mund të kontrollojnë dosjet me iniciativën e tyre apo në përgjigje të kërkesave të individëve për dosjet e tyre. Në disa shtete, ligji kërkon informata nga shërbimet e inteligjencës kur të shkëmbejnë informacionet me institucionet tjera apo kur i fshijnë dosjet me të dhëna. Në disa shtete, organet mbikëqyrëse kontrollojnë edhe menaxhimin e kërkesave nga shërbimi i inteligjencës për individët që i kanë parashtruar ato për të pasur qasje (shih Kutinë 5).

Si mund tu qasen individët të dhënave të tyre personale?

Në shtete demokratike, anëtarët e publikut kanë të drejtë të aplikojnë për qasje në të dhënat e tyre personale që mbahen nga shërbimet e inteligjencës. (shih Kutinë 5 për një shembull se si ky proces funksionon në Gjermani). Për të fituar qasje në të dhëna personale, ata parashtrojnë kërkesë drejtpërdrejt tek shërbimet e inteligjencës, apo përmes anëtarit të ekzekutivit përgjegjës për shërbimet e inteligjencës. Pas shikimit të të dhënave të tyre personale, ata mund të jenë në gjendje të shlyejnë dhe/ose ndryshojnë të dhënat.

Kutia 5: Ligji Gjerman për qasje në të dhënat personale që mbahen nga shërbimet e inteligjencës⁹

Ligji gjerman u mundëson njerëzve të drejtën e tyre të përgjithshme për qasje në të dhënat e tyre personale që mbahen nga shërbimi i inteligjencës. Aplikacionet dërgohen direkt në shërbimin për inteligjencës. Pjesa në vazhdim pasqyron funksionimin e këtij procesi.

Aplikimi për qasje në të dhënat personale që mbahen nga shërbimet e inteligjencës

- Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës do të ofrojë të dhënat me kërkesën e tij/saj, me informacionet gratis për të dhënat personale që ruhen për individin, nëse ai/ajo i referohet çështjeve konkrete dhe dëshmon të ketë një interesim special për informacionin që ai/ajo kërkon.

Argumentet për refuzimin e qasjes në të dhënat personale

- Informacionet nuk do të jepen nëse:
 1. kjo do të paragjykonte përmbushjen e mirëfilltë të detyrave,
 2. kjo do të ekspozonte burimet, apo nëse ekziston droja që njohuritë apo modus operandi i Zyrës Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës do të mund të eksplorohej,
 3. kjo do të dëmtonte sigurinë publike apo do të ishte dëmtuese për Zyrën Federale, apo nëse
 4. të dhënat apo fakti që ato ruhen duhet të mbahet sekrete në përputhje me dispozitat ligjore apo për nga natyra, për të shmangur nëpërkëmbjen e interesave të arsyetueshme të palës së tretë.
- Vendimi do të merret nga kryesuesi i Zyrës Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës apo nga anëtari i stafit i autorizuar në mënyrë eksplicite.
- Obligimi për të ofruar informacione nuk do të përfshijë origjinën e të dhënave dhe pranuesit e të dhënave të transferuara.
- Arsyet për refuzimin e ofrimit të të dhënave nuk ka nevojë të deklarohen nëse një gjë e tillë rrezikon qëllimin e refuzimit të dhënies së informacionit. Arsyet për refuzim do të regjistrohen zyrtarisht.

Arsyet për ankesë

- Në rast të refuzimit për të dhënë informacione për të dhënat, subjekti do të informohet për bazat ligjore për arsyet e mosdhënies së informacionit dhe për faktin se ai/ajo mund të ankohet tek Komisionari Federal për Mbrojtjen e të Dhënave, i cili me kërkesën e tij do të pajiset me informacion përveç nëse Ministria Federale për Punë të Brendshme vendos si rast i veçantë një gjë e tillë do të mund të rrezikonte sigurinë e Federatës apo shtetit federal.

Në disa raste ligjet dhe rregulloret lejojnë që shërbimet e inteligjencës të refuzojnë kërkesat nga individët për të pasur qasje në të dhënat e tyre personale. Për shembull, ata mund të refuzojnë kërkesat me qëllim të vazhdimit të hetimeve jashtë sferës publike, për të ofruar sigurinë publike apo për të mbrojtur interesat e sigurisë kombëtare. Rëndom, shërbimet e inteligjencës nuk janë të detyruara që të justifikojnë mosdhënien e arsyeve për refuzimin e kërkesave. Mirëpo, organet e jashtme të mbikëqyrjes mund të kontrollojnë vendimet e shërbimeve të inteligjencës për refuzimin e këtyre kërkesave. Individët mund të ankohen tek këto organe dhe të kërkojnë rishqyrtimin e kërkesave të tyre. Kjo ndihmon që të sigurohemi që refuzimet për qasje në të dhënat personale të jenë shumë të domosdoshme.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i Inteligjencës

Ç'është bashkëpunimi ndërkombëtar i inteligjencës?

Termi "bashkëpunimi ndërkombëtar i inteligjencës" përshkruan mënyrat se si shërbimet e inteligjencës dhe të sigurisë së dy apo më shumë vendeve punojnë së bashku. Shërbimet e inteligjencës bashkëpunojnë me subjekte të huaja në tri mënyra kryesore. Së pari, në mënyrën më të zakonshme, shërbimet e inteligjencës shkëmbejnë informacionin me homologët e tyre ndërkombëtar. Ata mund të shkëmbejnë edhe/apo të dhëna të pa përpunuara apo të japin edhe analiza të informacioneve këtyre shërbimeve të inteligjencës.

Së dyti, disa shërbime të inteligjencës mund të zhvillojnë operacione të përbashkëta me partnerë të huaj. Për shembull, agjentë të shërbimeve të ndryshme të inteligjencës mund të bashkëpunojnë për të mbledhur informacione. Apo shërbimi i inteligjencës së një vendi mund të shfrytëzojë infrastrukturën e tyre të inteligjencës së bashku me një shërbim të huaj të inteligjencës.

Së treti, bashkëpunimi ndërkombëtar i inteligjencës mund të përfshijë edhe shkëmbimin e njohurive dhe të ekspertizës. Për shembull, shërbimet e inteligjencës mund të trajnojnë homologët e tyre të huaj apo të dërgojnë zyrtarë të inteligjencës për të mbështetur punën e shërbimit të inteligjencës së huaj.

Pse shërbimet e inteligjencës bashkëpunojnë me qeveritë dhe shërbimet e huaja të inteligjencës?

Shërbimet e inteligjencës bashkëpunojnë me partnerët e huaj sepse një bashkëpunim i tillë u jep atyre qasje më të madhe në informacion dhe në eksper-

tizë. Shërbimet e inteligjencës në një vend mund të mos kenë resurse dhe ekspertizë të mjaftueshme për të mbledhur informacione për kërcënimet relevante në të gjitha rajonet e botës. Prandaj, ata duhet të mbështeten në agjencitë e huaja; partnerët kanë pozitën gjeografike dhe njohuritë për grupet specifike, gjuhët dhe kulturat për të mbledhur informacionin e nevojshëm. Shërbimet e inteligjencës në një vend mund t'ia japin informacionin agjencisë homologe të huaj në shkëmbim të një informacioni apo resursi tjetër, siç mund të jenë pajisjet apo të hollat. Bashkëpunimi ndërkombëtar mes shërbimeve të inteligjencës është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm sepse grupe që kërcënojnë sigurinë e shteteve dhe të popujve përkatëse shpesh veprojnë edhe jashtë kufijve dhe në një numër shtetesh.

Cilat janë rreziqet e bashkëpunimit ndërkombëtar të inteligjencës?

Bashkëpunimi në mes qeverive të huaja dhe shërbimeve të inteligjencës paraqet një sërë rreziqesh për të gjitha palët e involvuara. Së pari, bashkëpunimi ndërkombëtar paraqet rrezik të konsiderueshëm për të drejtat e njeriut të cilat mbrohen me të drejtën ndërkombëtare. Bashkëpunimi ndërkombëtar paraqet kërcënim për të drejtat e njeriut kur shërbimet e inteligjencës shkëmbejnë të dhëna personale me subjektet e huaja. Për shembull, një shërbim i inteligjencës që ka marrë të dhëna personale mund t'i përdorë ato në ndonjë mënyrë që do të mund të shkelte të drejtat e njeriut. Ata mund të i përdorin të dhënat personale për të identifikuar individë dhe t'i mbajnë ata në mënyrë joligjore dhe/apo të i keqtrajtojnë ata. Në përgjithësi, shërbimet e inteligjencës u tregojnë partnerëve të huaj se si mund të përdorin të dhënat personale që i shkëmbejnë, por megjithatë kanë kontroll të pakët për të mbikëqyruar sesi ata i përdorin ato të dhëna.

Së dyti, në shumë raste, shërbimet e inteligjencës nuk e dinë se si këto mekanizma të huaj i kanë mbledhur këto informacione dhe nëse ato informacione janë marrë në mënyrë të ligjshme. Përkatësisht, ata mund të mos dinë që një organ i huaj mund të ketë përdorur torturën apo taktika të tjera të paligjshme për të marrë këtë informacion. Por, nëse zyrtarët e inteligjencës e dinë që informacioni i marrë nga burimet vendore apo ndërkombëtare ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut, atëherë ato mund të konsiderohen si bashkëfajtor apo bashkëpjesëmarrës në ato shkelje.

Disa shërbime të inteligjencës do të donin të bashkëpunonin me partnerë të huaj për të parandaluar autoritetet e tyre që t'i kontrollojnë aktivitetet e tyre. Përkatësisht, ata do të donin që shmangnin kontrollin dhe mbikëqyrjen ligjore që autoritetet do të

mund të ushtronin për ti mbajtur ata llogaridhënës për respektimin e të drejtave të njeriut derisa ata ushtrjnë kompetencat speciale për mbledhjen e informacionit. Përfundimisht, përpos kërcënimit të të drejtave të njeriut, bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e inteligjencës mund ta dëmtoj edhe reputacionin e shtetit dhe marrëdhëniet e tij me jashtë. Për shembull, shërbimet e inteligjencës mund të bashkëpunojnë me agjencitë e jashtme të inteligjencës në një mënyrë që mund të ndërhyjë në politikën e jashtme të atij shteti. Duke pas parasysh këtë rrezik, shtetet mundohen ta kontrollojnë bashkëpunimin e tyre ndërkombëtar në fushën e shërbimeve të inteligjencës sa me shumë që është e mundur.

Si e kontrollojnë shtetet bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e inteligjencës?

Ligjet kombëtare rregullojnë bashkëpunimin ndërkombëtar me qeveritë e huaja dhe shërbimet e inteligjencës. Ligjet edhe rregulloret e tilla saktësojnë se me kë mund të bashkëpunojnë shërbimet e inteligjencës; çfarë lloj shkaqesh dhe kushtesh duhet të ekzistojnë për të bashkëpunuar me organe të tilla; dhe si do t'i autorizoj dhe monitoroj qeveria këto operacione (shih Kutinë 6 mbi atë se si rregullohen marrëdhëniet ndërkombëtare në fushën e inteligjencës në Kroaci).

Duke pasur parasysh rreziqet që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e inteligjencës, ligjet kombëtare kërkojnë nga shërbimet e inteligjencës ta marrin aprovimin nga ekzekutivi para se të lidhin marrëveshje me ndonjë organ të huaj. Përveç kësaj, ekzekutivi zakonisht duhet që të aprovoj operacione të përbashkëta apo aktivitete që përfshijnë shkëmbimin e informatave mbi rreziqet që mund të kanosen. Aprovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e inteligjencës nga ana e ekzekutivit, posaçërisht të aktiviteteve të ndjeshme, siguron që shërbimet e inteligjencës nuk operojnë të pakontrolluara nga shteti.

Çfarë lloj kontrollesh aplikohen me rastin e shkëmbimit të informacionit me shërbimet e huaja të inteligjencës?

Shoqëritë demokratike kanë ligje dhe rregullore që kontrollojnë shkëmbimin e informacioneve të shërbimeve të inteligjencës me shërbimet e huaja (shih Kutinë 6). Ligjet përkufizojnë atë se kur dhe në çfarë rrethanash shërbimet e inteligjencës mund të shkëmbejnë informacion me ndonjë organ të huaj. Për shembull, shërbimet e inteligjencës mund të kërkojnë informacion nga këto organe të huaja vetëm atëherë kur është e nevojshme për të përmbushur mandatin e tyre. Gjithashtu, ata do t'i japin informacione këtyre

organeve të huaja vetëm atëherë kur është e nevojshme për të përmbushur mandatin e tyre.

Përveç kësaj, ligjet kërkojnë nga shërbimet e inteligjencës që të marrin në konsideratë atë se a është në interes të mirë të shtetit shkëmbimi i ndonjë informacioni të veçantë.

Për shembull, shumë ligje kërkojnë nga shërbimet e inteligjencës të marrin në konsideratë atë se a i shërben politikës se jashtme të shtetit shkëmbimi i informacionit me ndonjë entitet tjetër. Ajo çfarë është me me rëndësi është që shërbimeve të inteligjencës u kërkohej t'i marrin parasysh edhe efektet e shkëmbimit të informacionit në individë që janë subjekt i informacionit. Në shoqëritë demokratike, ligjet e ndalojnë shkëmbimin e informacionit me ndonjë organ të huaj nëse një gjë e tillë ka gjasa të rrezikoj jetën e individëve apo shkelë të drejta të tjera të njeriut.

Përveç ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë punën e inteligjencës, shërbimet e inteligjencës kanë edhe kushtet e tyre për shkëmbim të informacionit me partnerë të jashtëm. Shembujt me të zakonshëm janë ata që kanë të bëjnë me parimin e "kontrollit nga ana e ofruesit të informacionit" dhe "rregulli për palët e treta". Këto rregulla joformale aplikohen në shumicën e rasteve të shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit. "Kontrolli nga ofruesi i informacionit" i referohet parimit që organi i inteligjencës i cili e jep informacionin i dikton kufijtë e përdorimit të këtij informacioni. "Rregulli për palët e treta" nënkupton se pranuesi i informacionit nuk është i lejuar ta ndajë atë me ndonjë agjenci tjetër apo palë të tretë pa lejen e shërbimit të inteligjencës prej të cilit buron ky informacion. Këto parime ndihmojnë në parandalimin e shpalosjes së paautorizuar të informacionit të ndjeshëm.

Shërbimet e inteligjencës shpesh i bashkëngjisin edhe ndonjë shënjim informacionit të shkëmbyer të cilit shpesh i referohet si "vërejtje". Këto shënjime përcaktojnë se si mund të përdoret informacioni i shkëmbyer. Për shembull, këto shënjime mund t'i ndalojnë agjencitë që të përdorin informacionin e caktuar si bazë për të arrestuar apo paraburgosur dike. Shërbimet e inteligjencës mbajnë të drejtën që t'i kërkojnë informacion organit të huaj të cilit i kanë dhënë informata mbi atë se kujt i është dhënë ky informacion dhe si është përdorur ai. Rregullat e tilla joformale ndihmojnë në minimizimin e keqpërdorimit të informacionit nga ana e organit të huaj dhe njëkohësisht mund të promovojë respektim me të madh të të drejtave të njeriut.

Si mbikëqyret bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e inteligjencës?

Në shoqëritë demokratike, organet e mbikëqyrjes se jashtme monitorojnë bashkëpunimin ndërkombëtar

Kutia 6: Rregulloret e Kroacisë mbi bashkëpunimin me entitet e huaja në fushën e inteligjencës⁹

Akti për sistemin e inteligjencës së sigurisë së Republikës së Kroacisë siguron bazën ligjore për bashkëpunimin e shërbimeve kroate të inteligjencës me subjektet e huaja si dhe përkufizon kontrollet që vlejnjë për këmbimin e të dhënave personale me subjektet e huaja.

Neni 59

1. Në bazë të zotimeve ndërkombëtare, agjencitë e sigurisë dhe inteligjencës mund të bashkëpunojnë me shërbimet e huaja të sigurisë, inteligjencës dhe shërbimeve tjera përkatëse, përmes këmbimit të informatave, pajisjeve, aktiviteteve të përbashkëta në fushëveprimin e tyre përkatës si dhe përmes trajnimit të punonjësve.
2. Vendosja dhe pezullimi i bashkëpunimit me secilin shërbim të huaj miratohet nga Këshilli i Sigurisë Kombëtare në bazë të rekomandimeve të drejtorëve të agjencive të sigurisë dhe inteligjencës si dhe mendimit paraprak të Këshillit për Bashkërendimin e Agjencive të Sigurisë dhe Inteligjencës.

Neni 60

1. Agjencitë e sigurisë dhe inteligjencës mund t'i komunikojnë shërbimeve përkatëse të huaja informatat mbi qytetarët e Republikës së Kroacisë në qoftë se marrin të dhëna relevante se ai person është kërcënim për sigurinë kombëtare të shtetit të cilit i ipen të dhënat apo për vlerat e mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare. Informatat nuk do të ofrohen nëse kjo do të ishte në kundërshtim me interesat e Republikës së Kroacisë ose nëse mbrojtja e interesave të personit në fjalë ka vlerë më të madhe.
3. Të dhënat e ofruara duhen shënuar në dosje. Të dhënat e tilla do të përcillen me një njoftim që tregon që ato mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë si dhe që agjencia e sigurisë dhe inteligjencës të ketë dhënë të dhënat mban të drejtën e saj për të kërkuar llogari mbi mënyrën e përdorimit të atyre informatave.

bëtar në fushën e inteligjencës në mënyrë që të sigurojnë se gjithçka është në pajtim me ligjin. Ata e monitorojnë bashkëpunimin në fushën e inteligjencës në disa mënyra. Së pari, ata i analizojnë marrëveshjet që shërbimet e inteligjencës i kanë lidhur me partnerët e jashtëm që të sigurohen se këto marrëveshje janë në pajtim me ligjin.

Së dyti, në disa shtete, shërbimet e inteligjencës duhet të informojnë organin mbikëqyrës mbi bartjen e informatave tek organet e huaja. Duke ditur për bartjet e tilla në kohë, organi mbikëqyrës është në gjendje të vëzhgojë vazhdimësinë, si dhe sipas nevojës, edhe të hetojë marrëdhëniet bashkëpunuese të caktuara dhe veprimtaritë e shërbimeve të caktuara të inteligjencës. Organet mbikëqyrëse mund të hulumtojnë edhe informatat që shërbimet e inteligjencës i kanë dërguar organeve të huaja. Këqyrja e informatave të këmbyerë i mundëson atyre të hulumtojnë nëse vendimi për dërgimin e informatave ka qenë i domosdoshëm dhe i duhur, në kuptimin e implikimeve të mundshme në të drejtat e njeriut të individit(ëve) në fjalë.

Së treti, organet e jashtme të mbikëqyrjes hetojnë pohimet e keqpërdorimeve në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar të inteligjencës. Për shembull,

ata bëjnë hetime të veprimeve të shërbimeve të inteligjencës në rastet e veçanta ku individët mund të kenë qenë të keqtrajtuar.

Shfrytëzimi i kompetencave nga shërbimet e inteligjencës për arrestimin dhe mbajtjen

A duhet që shërbimet e inteligjencës të kenë fuqi për arrestimin dhe mbajtjen e individëve?

Në shumicën e shoqërive demokratike, e drejta vendore nuk i lejon shërbimeve të inteligjencës të shfrytëzojnë fuqinë e arrestimit dhe mbajtjes. Këto pushtete zakonisht mbështesin zbatimin e ligjit, e më pak rolin e shërbimeve të inteligjencës në grumbullimin e informatave. E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk lejon arrestimin dhe/ose mbajtjen e individëve me qëllim të mbledhjes së informatave.

Megjithatë, disa shtete demokratike i japin shërbimeve të inteligjencës mandatin të arrestojë dhe mbajnë individë që kanë kryer apo duan të kryejnë vepra penale kundër sigurisë kombëtare. Për shem-

bull, ato mund të arrestojnë persona të përfshirë në përgatitjen e sulmeve terroriste apo shpërndarjen e armëve të shkatërrimit në masë.

Është më se e zakonshme për një shërbim të inteligjencës të ketë mandatin për të përdorur fuqinë e arrestimit dhe mbajtjes në shtete që nuk kanë organizata të ndara të inteligjencës, si dhe i japin policisë funksionet e inteligjencës. Në sisteme të tilla, individët që janë përgjegjës për mbledhjen e inteligjencës kanë mundësi të bëjnë hetimet penale të akteve terroriste, si dhe janë përgjegjës për arrestimin dhe mbajtjen e personave të dyshuar për ato vepra. Në këtë kontekst, e drejta vendore mund të ketë nevojë t'i autorizojë shërbimet e inteligjencës që të përdorin fuqinë e arrestimit dhe mbajtjes.

Çfarë standardesh ndërkombëtare vlejné për përdorimin e kompetencave për arrestimi dhe mbajtje?

Shoqëritë demokratike të cilat i lejojnë zyrtarëve të inteligjencës të arrestojnë dhe mbajnë individë, i vendosin brenda të drejtës vendore standardet ndërkombëtarisht të njohura të arrestimit dhe mbajtjes (shih Kutinë 7).

Standardet në vijim vlejné për shërbimet e inteligjencës në kategoritë në vijim:

Ligjet dhe arsyeshmëria për arrestimin dhe mbajtjen e individëve; trajtimi i individëve në mbajtje; si dhe mbikëqyrja e shqyrtimi i arrestimeve dhe mbajtjes.

Ligjet

Shërbimet e inteligjencës e kanë të ndaluar me ligj të arrestojnë dhe mbajnë njerëz me qëllimin e vetëm të mbledhjes së informatave. Ligji, në rrethana të veçanta, mund t'i autorizojë ato të arrestojnë dhe mbajnë individë që kanë kryer krime kundër sigurisë kombëtare apo që paraqesin kërcënim të drejtpërdrejt ndaj sigurisë kombëtare.

Trajtimi i të mbajturve (të arrestuarve)

Shërbimet e inteligjencës duhet të respektojnë të drejtat njerëzore të individit që janë arrestuar dhe mbajtur. Ekzistojnë veprime që duhen kryer si dhe veprime që nuk duhen kryer. Për shembull, shërbimet e inteligjencës duhet të sigurojnë që individit i mbajtur të ketë qasje ndaj një avokati, si dhe që të jetë në gjendje të kontaktojë familjen. Gjithashtu, ato duhet të sigurojnë që i mbajturi të gëzojë kushte adekuate të jetesës derisa është në arrest. Shërbimet e inteligjencës duhet të përmbahen nga çdo formë e keqtrajtimit të të arrestuarve.

Mbikëqyrja

Mbikëqyrja gjyqësore për mbajtjet (arrestimet) është thelbësore për të parandaluar mbajtjen arbitrare të individëve. Kjo mbikëqyrje obligon gjykatën të shqyrtojë ligjshmërinë e gjitha mbajtjeve. Gjykata, e jo zyrtari i inteligjencës që ka arrestuar dhe ka mbajtur individin, vendos nëse ka baza legjitime për vazhdimin e mbajtjes. Nëse të paraburgosurit nuk akuzohen për një vepër penale, ata duhen liruar. Përveç kësaj, institucioni i Ombudspersonit apo organet tjera të të drejtave të njeriut bëjnë inspektime të objekteve të paraburgimit. Në shumë shtete, organet e tilla mund të bëjnë vizita të paparalajmëruara për të siguruar trajtimin korrekt të paraburgosurve.

A kanë nevojë shërbimet e inteligjencës për objekte të veçanta të paraburgimit?

Shoqëritë demokratike nuk i lejojnë shërbimeve të inteligjencës që të kenë objektet e tyre të mbajtjes. Në shtetet që i japin shërbimeve të inteligjencës fuqinë e arrestimit dhe mbajtjes, këto organizata ndajnë të njëjtit objekte të paraburgimit që shfrytëzohen nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Objektet e përbashkëta të mbajtjes ndihmojnë të siguroarit që zyrtarët e inteligjencës të mos i mbajnë individët në mënyrë arbitrare, si dhe që t'i trajtojnë ata në pajtim me ligjet kombëtare të cilat njohin standardet ndërkombëtarisht të pranuar për trajtimin e personave në paraburgim.

Përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga shërbimet e inteligjencës

A ju lejohet shërbimeve të inteligjencës të vrasin?

Shërbimeve të inteligjencës nuk u lejohet të vrasin. E drejta ndërkombëtare i ndalon shtetet të vrasin persona, përveç në tri situata, e edhe atëherë vetëm në bazë të kontroleve dhe kufizimeve specifike: (1) në një konflikt të armatosur, një luftëtar mund të vrasë luftëtarin armik por vetëm nëse përmbushen disa kushte qartësisht të definuara. (2) Autoritetet e zbatimit të ligjit mund të përdorin forcën vdekjeprurëse vetëm nëse është qartësisht e domosdoshme për të parandaluar kërcënimin e drejtpërdrejtë ndaj jetës, si dhe kur nuk ka mënyra tjera për të luftuar atë kërcënim. (3) Pas një procesi gjyqësor, gjykata mund të vendosë dënimin me vdekje si formë e dënimit kapital për vepra specifike e të rënda penale.

Kutia 7: Standardet ndërkombëtare për arrestin dhe paraburgimin

E Drejta Ndërkombëtare rregullon arrestimin dhe paraburgimin nga të gjitha institucionet shtetërore duke përfshirë edhe shërbimet e inteligjencës. Marrëveshjet ndërkombëtare mbi të drejta e njeriut, përfshirë këtu edhe Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejta Civile dhe Politike (ICCPR) dhe Konventën kundër Torturës (CAT), përmbajnë disa dispozita kyçe në këtë aspekt. Organet e OKB mbi Parimet për Mbrojtjen e të gjithë personave nga çfarëdo forme e paraburgimit ose burgosjes (Parimet e OKB mbi paraburgimin) i plotësojnë rregullat që i përmbajnë këto traktate¹⁰. Përderisa shumica e shteteve demokratike nuk lejojnë që shërbimet e tyre të arrestojnë apo paraburgosin askënd edhe nëse këtyre shërbimeve u ipen kompetenca të tilla, ata janë të obliguar që të u binden standardeve ndërkombëtare si në vijim.

Baza Ligjore për arrestim dhe paraburgim

- Secili ka të drejtën në lirinë dhe sigurinë e personit. Asnjëri nuk duhet të i nënshtrohet arrestimit apo paraburgimit arbitrar. Askush nuk mund të privohet nga liria përveç se në baza të tilla të cilat janë në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligj. (ICCPR, neni 9.1)

Standardet procedurale për ndalim dhe arrestim

- Arrestimi, ndalimi (paraburgimi) dhe burgosja duhet të kryhen vetëm në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe nga zyrtarët kompetent apo nga personat e autorizuar për atë qëllim (Parimet e OKB-së mbi Paraburgimin, parimi 2)
- Kushdo që arrestohet duhet që në momentin e arrestimit të njoftohet në lidhje me arsyen e arrestimit të tij dhe duhet të njoftohet sa më shpejt me akuzat që i ngarkohen. (ICCPR, Neni 9.2)
- Aty me kohë duhet të regjistrohen:
 - a. Arsyet për arrest;
 - b. Koha e arrestimit dhe dërgimi i të arrestuarit në vendin e mbajtjes si dhe paraqitja e tij e parë para autoriteteve gjyqësore apo ndonjë autoriteti tjetër;
 - c. Identiteti i zyrtarëve të zbatimit të ligjit në fjalë;
 - d. Informata të sakta për vend-ndalimin në fjalë.
- Të dhënat e tilla duhet komunikuar personit të ndaluar, apo mbrojtësit të tij, nëse ka në formën e parashikuar me ligj. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 12)
- Kohëzgjatja e marrjes në pyetje e personit të ndaluar ose të burgosur, intervalet ndërmjet marrjes në pyetje, identiteti i personave zyrtarë të cilët e kanë marrë në pyetje si dhe personat e tjerë të pranishëm duhet regjistruar dhe vërtetuar në forma të tilla siç mund të jenë të përcaktuara me ligj. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 23.1)
- Personi i paraburgosur gëzon të drejtën për ndihmën e një mbrojtësi ligjor. Menjëherë pas arrestimit nga autoritetet kompetente duhet të informohet për të drejtën e tij dhe duhet të i ofrohen lehtësimet e nevojshme për ushtrimin e kësaj të drejte. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 17.1)
- Personi i arrestuar menjëherë pas arrestimit dhe pas çdo transferimi prej një lokacioni të paraburgimit apo burgut në ndonjë lokacion tjetër, personi i ndaluar apo i burgosur gëzon të drejtën të njoftojë apo të kërkojë nga autoriteti kompetent që të njoftojnë anëtarët e tij të familjes ose personave të tjerë përkatës të përgjedhur nga ai, në lidhje me arrestimin apo burgosjen e tij apo edhe për transferimin e tij si dhe vendin ku mbahet në paraburgim. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 16.1)

Standardet për mbrojtjen e personave në paraburgim

- Të gjithë personat të privuar nga liria duhet të trajtohen në mënyrë humane dhe me respekt për dinjitetin e tij njerëzor. (ICCPR, neni 10)
- Asnjë person nën çdo formë të ndalimit ose burgimit nuk duhet të i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës apo ndëshkimit. Asnjë rrethanë nuk mund të përdoret si justifikim për torturë ose trajtim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues apo dënim. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 6, ICCPR neni 7, CAT nenet: 2.2-3)
- Ndalohet përfitimi i padrejtë i situatës së një personi të ndaluar ose të burgosur me qëllim që të detyrohet të rrefehet, të fajësojë veten ndryshe ose për të dëshmuar kundër ndonjë personi tjetër. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, 21.1)
- Asnjë person i paraburgosur gjatë marrjes në pyetje nuk duhet të i nënshtrohet, dhunës, kërcënimeve apo metodave të marrjes në pyetje të cilat dëmtojnë cilësinë e tij në marrjen e vendimeve apo gjykimin e tij. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 21.2)
- Shtetet duhet të mbajnë nën një shqyrtim sistematik rregullat, udhëzimet, metodat dhe praktikën e marrjes në pyetje si dhe marrëveshjet mbi mbajtjen dhe trajtimin e personave që i janë nënshtuar çfarëdo forme të arrestimit, paraburgimit apo burgosjes në cilindo rajon nën juridiksionin e tij me qëllim të parandalimit të çfarëdo rasti të torturimit. (CAT, neni 11)

Mbikëqyrja dhe shqyrtimi i paraburgimit

- Çdo formë e ndalimit ose burgosjes si dhe të gjitha masat që prekin në të drejtat e njeriut të një personi nën çfarëdo forme të ndalimit ose burgosjes duhet urdhëruar ose të jenë subjekt i kontrollit efektiv nga një autoritet gjyqësor ose ndonjë autoriteti tjetër. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 4)
- Çdokush që privohet nga liria e tij në masën e arrestit ose ndalimit, gëzon të drejtën të i nënshtrohet procedurës para një gjykate, në mënyrë që gjykata pa vonesë të vendosë lidhur me ligjshmërinë e burgimit dhe të urdhërojë lirimin e tij në qoftë se burgimi është i paligjshëm. (ICCPR, neni 9.4)
- Çdokush që ka qenë viktimë e një arrestimi ose ndalimi të paligjshëm ka të drejtë për dëmshpërblim. (ICCPR, neni 9.5)
- Shtetet duhet të sigurojnë që çdo individ i cili pretendon se ka qenë i nënshtuar torturës, [...] ka të drejtë ankese, dhe që rasti i tij menjëherë dhe në mënyrë të paanshme të shqyrtohet nga organet kompetente. (CAT, nenet 12-13)
- Në mënyrë që të mbikëqyret respektimi i rreptë i ligjeve dhe rregulloreve, qendrat e paraburgimit duhet vizituar rregullisht nga persona të kualifikuar dhe me përvojë të emëruar dhe përgjegjës për të, nga autoriteti kompetent i cili është tjetër nga autoriteti i cili është drejtpërdrejt përgjegjës në administrimin e qendrës së paraburgimit apo burgut. (Parimet e OKB-së mbi paraburgimin, parimi 29.1)

Shumica e shteteve demokratike, zyrtarëve të shërbimeve të tyre të inteligjencës, nuk u lejojnë përdorimin e forcës të çfarëdo lloji. Në fakt, zyrtarët e shërbimit të inteligjencës i nënshtrohen të njëjtave rregulla për përdorimin e forcës sikurse edhe pjesëtarët publikë. Shërbimet e inteligjencës duhet të kërkojnë ndihmën e policisë në qoftë se përdorimi i forcës është i nevojshëm. Shërbimet e inteligjencës veçanërisht mund të kërkojnë ndihmë nga policia për të arrestuar një individ i cili ka kryer apo është gati për të kryer një vepër të rëndë penale. Përveç kësaj, zyrtarët e zbulimit mund të kërkojnë që ata vetë të jenë të shoqëruar nga policia në misionet ku siguria e tyre fizike mund

të jetë e kërcënuar. Për shembull, zyrtarët e shërbimit të inteligjencës mund të shoqërohen nga zyrtarët policorë për të përmbaruar një urdhër për largimin e ndonjë objekti apo për të instaluar ndonjë mekanizëm të përgjimit në ndonjë shtëpi private.

Disa shtete demokratike u lejojnë shërbimeve të tyre të zbulimit të përdorin pushtetin e arrestimit dhe të paraburgimit (shih faqen 27). Në qoftë se gjatë një arrestimi, zyrtarët e shërbimit të inteligjencës ballafaqohen me ndonjë kërcënim të pashmangshëm për jetën e tyre dhe të tjerëve, atëherë ata mund të përdorin forcën vdekjeprurëse. Në të tilla raste, ata

duhet të respektojnë të njëjta rregulla dhe ligje që zbatohen nga organet e zbatimit të ligjit (shih Kutinë 8). Kjo do të thotë se çdo përdorimi i forcës duhet të jetë më se i nevojshëm dhe në proporcion me kërcënimin. Përveç kësaj, shërbimet e inteligjencës, ashtu si edhe organet e zbatimit të ligjit, duhet të raportojnë në lidhje me përdorimin e forcës vdekjeprurëse dhe do të i nënshtrohen hetimit nga një organ i pavarur.

Përse shoqëritë demokratike i kontrollojnë

Shërbimet e tyre të inteligjencës?

Janë katër arsye kryesore përse shoqëritë demokratike i kontrollojnë shërbimet e tyre të inteligjencës.

Së pari, shoqëritë demokratike i mbajnë përgjegjës udhëheqësit e tyre të zgjedhur për punën e të gjitha organeve dhe agjencive qeveritare që financohen nga parja publike. Shërbimet e inteligjencës nuk kanë përjashtim nga ky rregull. Prandaj, shoqëria demokratike i kontrollon shërbimet e inteligjencës në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e të gjithë personave të cilët vijnë në kontakt me shërbimet e inteligjencës.

Së dyti shërbimet e inteligjencës kanë fuqi të veçanta përmbledhjen e të dhënave që nuk janë në dispozicion për anëtarët tjerë të shoqërisë. Për atë, shoqëritë demokratike i kontrollojnë shërbimet e inteligjencës në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e njeriut, sidomos të gjithë individëve që ballafaqohen drejtpërdrejt me shërbimet e inteligjencës.

Kutia 8: Standardet ndërkombëtare mbi përdorimin e forcës nga zyrtarët publik

Ekstraktet e mëposhtëm nga ICCPR, Kodin i OKB mbi Sjelljet e Zyrtarëve të Zbatimit të Ligjit dhe Parimet Themelore të OKB-së mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga ana e Zyrtarëve të Zbatimit të Ligjit vlejné edhe për zyrtarët e shërbimeve të fshehta sa herë që ata përdorin forcën kundër ndonjë personi¹¹. Në qoftë se shtetet u japin shërbimeve të tyre të zbulimit kompetenca për paraburgosje dhe arrestim, ata duhet të sigurojnë që ato të jenë në përputhje me këto standarde, si dhe të gjitha të drejtat tjera të zbatueshme ndërkombëtare dhe vendore.

- Çdo qenie njerëzore ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga jeta e tij. (ICCPR, neni 6.1)
- Zyrtarët e zbatimit të ligjit mund të përdorin forcën vetëm atëherë kur është absolutisht e nevojshme dhe në masën e kërkuar për kryerjen e detyrës së tyre (KS i Zyrtarëve për Zbatimin e Ligjit, parimi 3)
- Zyrtarët e zbatimit të ligjit nuk do të përdorin armë zjarri kundër personave përveç në rast vetëmbrojtje apo mbrojtje e të tjerëve kundër kërcënimit të pashmangshëm për vdekje apo lëndime serioze, për të parandaluar kryerjen e një krimi të rëndë ku përfshin kërcënim për jetën, arrestimin e personit që paraqet një rrezik të tillë dhe i cili i reziston autoritetit të tyre, ose për të parandaluar arratisjen e tij apo të saj, dhe vetëm atëherë kur masat më pak ekstreme nuk mjaftojnë për të arritur këto objektiva. Në cilindo rast, përdorimi i qëllimshëm vdekjeprurës i armëve të zjarrit duhet të ndodhë vetëm kur është absolutisht e pashmangshme me qëllim të mbrojtjes së jetës. (Parimet mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit, parimi 9)
- Sa herë që përdorimi i ligjshëm i forcës dhe armëve të zjarrit është e pashmangshëm, zyrtarët e zbatimit të ligjit duhet të:
 - a. Tregojnë përmbajtje gjatë përdorimit në raste të tilla dhe të veprojnë në proporcion me seriozitetin e veprës penale dhe objektivat legjitime që duhet të arrihen;
 - b. Zvogëlojnë dëmet dhe lëndimet e të respektojnë ruajtjen e jetës njerëzore; (Parimet mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit, parimi 11)
- Qeveritë duhet të sigurojnë që përdorimi arbitrar apo abuziv i forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët e zbatimit të ligjit të dënohet si vepër penale sipas ligjit të tyre. (Parimet për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të zjarrit, parimi 7)
- Qeveritë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit do të sigurojnë që të kenë në dispozicion një proces efektiv shqyrtimi dhe se autoritetet e pavarura administrative apo prokurori janë në një pozitë për të ushtruar juridiksionin në rrethanat e duhura. (Parimet mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit, parimi 22)
- Personat e prekur nga përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit apo përfaqësuesit e tyre do të kenë qasje në një proces të pavarur, duke përfshirë edhe proces gjyqësor. (Parimet mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit, parimi 23)

Së treti, roli i tyre për mbledhjen e informatave ka potencial për çrregullimin e partive politike, mediat dhe institucionet e profesionet tjera. Shteti duhet të kontrollojë shërbimet e inteligjencës për të mbrojtur elementet vitale të një shoqërie demokratike..

Së katërti, shoqëritë demokratike kanë nevojë për kontroll demokratik mbi shërbimet e inteligjencës, sepse ligji i mundëson atyre të veprojnë në mënyrë sekrete. Për shembull, ata munden fshehurazi të dëgjojnë komunikimet e një individi, apo të filmojnë dhe fotografojnë shtëpitë e tyre private, Individi mund të mos jetë i vetëdijshëm që shërbimet e inteligjencës po marrin masa ndaj tij. Ai apo ajo nuk është në pozitë të kundërshtimit të atyre veprimeve. Për më tepër, individët dhe publiku i gjerë kanë pak mundësi të vëzhgojnë veprimet e shërbimeve të inteligjencës që bëhen në fshehtësi edhe kur janë të ligjshme. Duke marrë parasysh që shërbimet e inteligjencës nuk i nënshtrohen të njëjtit nivel të vëzhgimit publik si agjencitë tjera qeveritare, potenciali për praktika joefektive apo të paligjshme është i madh. Kështu, qeveritë kanë nevojë të kontrollojnë operacionet sekrete për të siguruar që shërbimet e inteligjencës punojnë me efektshmëri dhe në përputhje me ligjin.

Cilat institucione i kontrollojnë dhe/ose mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës?

Janë pesë lloje të rëndësishme të institucioneve që kontrollojnë dhe/ose mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës; menaxhmenti i brendshëm i vetë shërbimit (faqet 32-33), ekzekutivi (faqe 33), gjyqësori (faqe 33), parlamenti (faqet 34-42), si dhe organet profesionale të mbikëqyrjes (faqet 34-42).

Menaxhmenti i brendshëm

Çfarë roli luan menaxhmenti i brendshëm në kontrollimin e shërbimeve të inteligjencës?

Menaxhmenti i brendshëm kontrollon aktivitetet e përditshme të inteligjencës. Menaxhmenti siguron që zyrtarët e inteligjencës të kryejnë punën e tyre në mënyrë efektive dhe të përmbushin kërkesat e ekzekutivit. Gjithashtu është përgjegjës për përputhshmërinë e shërbimeve me ligjet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.

Menaxhmenti i brendshëm vendos procedurat për caktimin, raportimin dhe vlerësimin e gjitha aktiviteteve të inteligjencës. Përveç këtyre, ai shpall kodet

e mirësjelljes dhe dokumenteve tjera udhëzuese për personelin e inteligjencës. Menaxhmenti gjithashtu bashkërendon proceset për vlerësimin e performancës së personelit.

Kujt i raportojnë shërbimet e inteligjencës?

Shërbimet e inteligjencës i raportojnë ekzekutivit, parlamentit dhe publikut. Ato i raportojnë ekzekutivit mbi aktivitetet e ardhshme, ato në vijim si dhe ato të kryera. Ekzekutivi shfrytëzon raportimin e shërbimeve të inteligjencës për të vlerësuar nëse ato janë duke përmbushur mandatin e tyre dhe arritjen e prioriteteve më të larta të shërbimeve të inteligjencës.

Shërbimet e inteligjencës i raportojnë parlamentit ose në mënyrë direkte ose përmes ministrit përgjegjës për inteligjencë. Parlamenti shfrytëzon raportet e shërbimeve të inteligjencës për të kontrolluar aktivitetet e inteligjencës dhe për të informuar vendim-marrësit për ndarjet e ardhshme të buxheteve për shërbimet e inteligjencës. Inteligjenca nganjëherë dorëzon raporte për seancën plenare të parlamentit e cila zakonisht është publike.

Shërbimet e inteligjencës gjithashtu i raportojnë organeve të pavarura mbikëqyrëse; këto raporte shpesh përmbajnë informata të klasifikuara. Në disa sisteme, shërbimet e inteligjencës dhe/ose ministri apo ministrat përkatës i raportojnë një komisioni të caktuar brenda parlamentit apo një komisioni profesional mbikëqyrës që vepron jashtë parlamentit.

Shërbimet e inteligjencës gjithashtu shkruajnë raporte për audienca të gjera. Raportet publike ndërtojnë vetëdijen mbi punën e shërbimeve të inteligjencës dhe krijojnë besimin publik në to. Ato zakonisht publikohen në faqen e internetit të shërbimeve të inteligjencës.

Ligji vendor përgjithësisht obligon shërbimet e inteligjencës që të raportojnë para parlamentit dhe/ose ekzekutivit mbi aktivitetet e tyre të kryera në baza periodike, si p.sh. dy herë në vit. Organet parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes mund të kërkojnë raporte shtesë nga shërbimet e inteligjencës apo prej ministrit ekzekutiv në krye të shërbimeve të inteligjencës, për çështje të caktuara.

Kush emëron drejtorët e shërbimeve të inteligjencës?

Ligjet vendore përcaktojnë procedurat për emërimin e drejtorëve të shërbimeve të inteligjencës dhe kualifikimet e nevojshme për drejtor. Shefi i qeverisë apo

ministri përgjegjës për shërbime të inteligjencës, zakonisht emërojnë drejtorin e shërbimit të inteligjencës. Në shumë shtete, ekzekutivi duhet të konsultohet me liderë të partive opozitare para se të emërojnë drejtorin. Ata mund të kenë nevojë të konsultojnë edhe parlamentin. Parlamenti mund të bëjë pyetje për të emëruarit, apo në disa raste, edhe të organizojë dëgjime me të. Përfshirja e aktorëve tjerë në emërimin e drejtorëve ndihmon në parandalimin e emërimit të personave nga ekzekutivi për të promovuar apo mbrojtur interesat politike.

Pse drejtorët e shërbimeve të inteligjencës emërohen për një periudhë të caktuar?

Ligji i obligon drejtorët e shërbimeve të inteligjencës që të emërohen për një mandat të caktuar. Ata mund të shkarkohen nga pozita vetëm nëse shkelin disa rregulla specifike. Mandati i fiksuar ndihmon në mbrojtjen e punës së drejtorëve nga presionet politike apo ndryshimet në qeveri. Për shembull, mandatet e kufizuara e bëjnë të vështirë për një anëtar ekzekutivi që të sforcojë agjendën e tij apo saj mbi shërbimet e inteligjencës, duke kërcënuar drejtorin me shkarkim nga pozita, nëse ai apo ajo nuk merr një linjë të caktuar veprimi.

Ekzekutivi

Çfarë roli luan ekzekutivi në kontrollimin dhe vlerësimin e shërbimeve të inteligjencës?

Në shoqëri demokratike, ekzekutivi ka kontroll të përgjithshëm mbi shërbimet e inteligjencës. Anëtarët e ekzekutivit vendosin politikën e përgjithshme dhe prioritetet e shërbimeve të inteligjencës. Përveç këtyre, ekzekutivi ka përgjegjësi politike për shërbimet e inteligjencës; mbahet përgjegjës para parlamentit dhe publikut për veprimtarinë e inteligjencës.

Ekzekutivi është përgjegjës për autorizimin e aktiviteteve të inteligjencës që përbëjnë rrezik të konsiderueshëm për sigurinë e individëve, marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit dhe/ose reputacionin të tij. Në autorizimin e këtyre aktiviteteve, ekzekutivi merr përsipër përgjegjësinë politike dhe siguron edhe kontrollin tjerë mbi shërbimet e inteligjencës.

Ekzekutivi mbikëqyr shërbimet e inteligjencës për të siguruar që ato të kryejnë funksionet e veta në mënyrë efektive dhe në përputhje me ligjin. Nëse ka pohime të keqpërdorimeve të bëra ndaj shërbi-

meve të inteligjencës, ekzekutivi mund të iniciojë hetime të aktiviteteve të caktuara të inteligjencës.

Derisa aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës bazohen në statute, ekzekutivi vendos rregullore për të ndihmuar çartësimin dhe zbatimin e ligjeve. Për shembull, ekzekutivi mund të shpallë udhëzime mbi standardet etike në bazë të statutit që ka të bëjë me shërbimet e inteligjencës.

Gjyqësori

Cili është roli i gjyqësorit në kontrollimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës?

Gjyqësori luan rol të rëndësishëm në kontrollimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës. Në shumë shtete, gjyqësori autorizon dhe mbikëqyr përdorimin e autorizimeve të veçanta të shërbimeve të inteligjencës (shih faqet 18-19 dhe kutinë 3). Gjykatat gjithashtu zgjidhin ankesat që parashtrohen kundër shërbimeve të inteligjencës, si dhe nëse kërkohet, vendosin mjetet juridike ndaj keqpërdorimeve të ndryshme (shih faqet 43-45). Përmes vendimeve të tyre, gjykatat vendosin standardet për kontrollimin e sjelljeve të ardhshme të shërbimeve të inteligjencës.

Gjithashtu, gjykatat vendosin mbi çështjet në lidhje me qasjen në apo zbulimin e informatave në lidhje me shërbimet e inteligjencës. Në shumë shtete demokratike, individët dhe organizatat e shoqërisë civile janë në gjendje të kërkojnë informata mbi secilën agjenci qeveritare. Qasja e fituar në këto informata mund t'i mundësojë shoqërisë të mbikëqyr aktivitetet e qeverisë, duke përfshirë shërbimet e saj të inteligjencës. Gjykatave mund t'iu kërkohet të gjykojnë mbi ato pretendime në lidhje me informatat për apo të mbajtura nga shërbimet e inteligjencës. Ato vendime merren në bazë të ligjeve për qasje në informata/liri të informimit. Përveç këtyre, gjykatat mund të obligohen të gjykojnë lëndët që parashtrohen kundër personave të akuzuar për zbulim të paligjshëm të informatave të klasifikuara që mbahen nga shërbimet e inteligjencës.

Përfundimisht, në shtetet demokratike ekzekutivi mund të kërkojë nga gjyqtarët aktualë apo të mëhershëm që të bëjnë hetime gjyqësore të rasteve apo aktiviteteve të kaluara në lidhje me shërbimet e inteligjencës.

Parlamenti

Cili është roli i parlamentit në mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës?

1. Ligjvënia

Parlamentet hartojnë dhe miratojnë ligjet që rregullojnë shërbimet e inteligjencës dhe themelojnë institucione për t'i mbikëqyrur ato. Derisa hartojnë legjislacionin për shërbimet e inteligjencës, anëtarët e parlamentit mundohen të fusin dispozita gjithëpërfshirëse mbi mbikëqyrjen e jashtme dhe llogaridhënien, respektimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Gjithashtu, parlamentet vëzhgojnë si dhe nëse ka nevojë, ndryshojnë projektligjet e propozuara. Përfundimisht, parlamentet zbulojnë dhe ndryshojnë ligjet ekzistuese sipas nevojës.

2. Kontrollimi i financave

PPoashtu, parlamentet kontrollojnë shpenzimin e parave publike nga shërbimet e inteligjencës; miratojnë buxhetet e ardhshme dhe shqyrtojnë shpenzimet e mëhershme. Në secilin vit, parlamentet miratojnë shpenzimet e projektuara. Gjatë këtij procesi, parlamentarët kanë mundësi të pyesin ekzekutivin për politikën dhe prioritetet e shërbimeve të inteligjencës. Parlamenti ka pushtetin që të refuzojë apo kufizojë financimin nëse ekzekutivi dhe/ose shërbimet e inteligjencës refuzojnë të marrin parasysh kërkesat e tyre. Kështu, parlamentarët luajnë rolin e tyre të mbikëqyrjes buxhetore për të ndikuar në politikën dhe veprimet e shërbimeve të inteligjencës.

Përveç miratimit të shpenzimeve të ardhshme, parlamentet janë të përfshirë edhe në shqyrtimin e shpenzimeve të mëparshme të shërbimeve të inteligjencës. Në disa shtete, parlamenti ka komisione buxheti që shqyrtojnë gjitha shpenzimet qeveritare. Në shtete tjera, institucionet kombëtare të auditimit e kryejnë këtë funksion nën mbikëqyrjen e parlamentit.

3. Mbikëqyrja e politikave dhe aktiviteteve

Parlamenti gjithashtu mbikëqyr administratën, politikën dhe aktivitetet operative të shërbimeve të inteligjencës. Kjo ndihmon në të siguruarit

që ato i përmbushin mandatet e tyre në mënyrë efektive dhe në pajtim me ligjin. Mbikëqyrja parlamentare e shërbimeve të inteligjencës organizohet në mënyra të ndryshme. Në disa shtete, komisionet parlamentare për mbrojtje apo për punë të brendshme mund të jenë përgjegjëse për mbikëqyrjen e inteligjencës. Megjithatë, një numër përditë e më i madh i shteteve janë duke themeluar komisione speciale parlamentare për mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës (shih faqet 38-42). Tjetërkund, parlamenti ka rol më indirekt në mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës. Ai mund të mandatojë një organ të jashtëm profesional për të ndërmarrë mbikëqyrjen e përditshme të shërbimeve të inteligjencës. Parlamenti mund të luajë rol në emërimin e organeve profesionale të mbikëqyrjes. Në shumë shtete demokratike, ato organe i raportojnë parlamentit, i cili pastaj mund të ndërmarrë veprime për të siguruar që gjetjet dhe rekomandimet e atij organi mbikëqyrës të adresohen.

Përfundimisht, parlamentet mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës duke bërë hetime të ngjarjeve apo aktiviteteve të caktuara që kanë të bëjnë me shërbimet e inteligjencës.

Organet profesionale të mbikëqyrjes

Cili është roli i mbikëqyrjes profesionale të inteligjencës?

Shtetet, përditë e më shumë, po themelojnë organe profesionale të mbikëqyrjes së inteligjencës, krahas atyre ekzistuese apo në vend të organeve parlamentare të mbikëqyrjes. Këto organe janë të pavarura nga shërbimet e inteligjencës, ekzekutivi dhe parlamenti. Ato përqendrohen ekskluzivisht në mbikëqyrjen e shërbimeve të caktuara të inteligjencës. Organet profesionale të mbikëqyrjes zakonisht marrin përsipër mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së këtyre shërbimeve, por mandati i tyre mund të përfshijë edhe vëzhgimin e efektshmërisë së operacioneve, praktikave administrative dhe financave të shërbimeve të inteligjencës (shih faqen 38 dhe Tabelën 2).

Parlamenti zakonisht emëron organet e mbikëqyrjes dhe ato i raportojnë parlamentit dhe/ose ekzekutivit. Për dallim nga anëtarët e komisioneve parlamentare të mbikëqyrjes së inteligjencës, shumica e anëtarëve të organeve profesionale mbikëqyrëse nuk janë anëtarë të parlamentit. Ata normalisht janë figura publike të larta, duke përfshirë anëtarët e njohur të shoqërisë civile, anëtarët e mëhershëm dhe aktualë të gjyqësorit, si dhe ish-politikanët.

Tabela 2: Krahasimi mes organeve të zgjedhura të mbikëqyrjes së inteligjencës në Belgjikë, Kanada, Afrikë të Jugut, dhe Mbretëri të Bashkuar¹²

	Belgjikë	Kanada	Afrika e jugut	Mbretëria e Bashkuar
Emri	Komisioni i përhershëm i Shqyrtimit të Agjencive të Inteligjencës	Komisioni i Shqyrtimit të Inteligjencës së Sigurisë	Komisioni i përbashkët i përhershëm për Inteligjencën	Komisioni për Inteligjencë dhe Siguri
Lloji	Organ profesional i mbikëqyrjes	Organ profesional i i mbikëqyrjes	Organ parlamentar i mbikëqyrjes	Organ parlamentar i mbikëqyrjes
Organet tjera relevante mbikëqyrëse	Komision i senatit përgjegjës për vëzhgimin e Komisionit të përhershëm të shqyrtimit të agjencive të inteligjencës	Inspektori i përgjithshëm i Shërbimit Kanadez të Sigurisë dhe Inteligjencës (IP)	Inspektori i Përgjithshëm i Inteligjencës (IP)	Komisioneri i Shërbimeve të Inteligjencës; Komisioneri i Përgjimit të Komunikimeve; Tribunali i Autorizimeve Hetuese
Përbërja	3 anëtarë; duhet të jetë një anëtar nga secili grup gjuhësor; Nuk mund të kenë pozitë ku zgjedhet.	2-4 anëtarë; Nuk mund të jenë anëtarë të parlamentit.	15 deputetë	9 deputetë nga secila dhomë e parlamentit; Nuk mund të jenë ministra (pra anëtarë të ekzekutivit)
Emërimi i anëtarëve	Emërohen nga Senati (dhoma e lartë e parlamentit).	Emërohen nga ekzekutivi pas konsultimit me liderët e partive opozitare.	Emërohen nga parlamenti përmes përfaqësimit proporcional, si dhe në bazë të emërimeve nga partitë.	Emërohen nga kryeministri në konsultim me liderin e partisë më të madhe opozitare.
Kohëzgjatja e mandatit	5 vjet, dy herë rizgjedhje.	5 vjet, rizgjedhje.	Mandati i parlamentit.	Mandati i parlamentit.

	Belgjikë	Kanada	Afrika e jugut	Mbretëria e Bashkuar
Mandati	<p>Shqyrtimi i aktiviteteve dhe metodave të shërbimeve të inteligjencës, rregullave dhe direktivave të tyre të brendshme;</p> <p>Komisioni duhet të sigurojë: (1) mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe të tjera nga shërbimet e inteligjencës; (2)</p> <p>Bashkërendimi dhe efektshmëria e shërbimeve të inteligjencës;</p> <p>Hetimi i ankesave;</p> <p>Ofrimi i këshillave mbi projektligjet, dekretet dhe direktivat.</p>	<p>Shqyrtimi i kryerjes së detyrave dhe funksioneve të shërbimeve;</p> <p>Shqyrtimi i udhëzimeve të lëshuara nga drejtori i shërbimit të inteligjencës;</p> <p>Rregulloret dhe marrëveshjet e shërbimit me subjekte vendore dhe të huaja; raportet e shërbimit dhe IP;</p> <p>Komisioni duhet të sigurojë që: (1) vepërimtaria e shërbimit të jetë në përputhje me ligjin në fuqi;</p> <p>Dhe (2) shërbimi nuk ushtron pushtetin e tij në mënyrë të paarsyeshme apo të panevojshme;</p> <p>Udhëzimi i shërbimit apo IP që të bëjë shqyrtime të veprimeve specifike;</p> <p>Apo kudo që e konsideron që do të ishte e përshtatshme;</p> <p>Të bëjë vetë një shqyrtim të tillë; të hetojë ankesat.</p>	<p>Shqyrton financat e shërbimeve të inteligjencës, duke përfshirë raportet e zyrës së auditorit;</p> <p>Pranon ankesat dhe urdhëron IP apo shërbimet e inteligjencës që t'i hetojnë ato; -</p> <p>Shqyrton raportet e IP; bën rekomandime mbi legjislacionin në lidhje me sigurinë kombëtare dhe inteligjencën.</p>	<p>Të hulumtojë shpenzimet, administrimin dhe politikat e shërbimeve të inteligjencës.</p>
Fuqitë hetuese	<p>Mund të thërras secilin person të dëshmojë nën betim para Komisionit;</p> <p>Mund të kërkojë ndihmën e organeve të zbatimit të ligjit që të detyrojnë personat të binden.</p>	<p>Kur hetohen ankesat, komisioni ka fuqitë e gjykatës:</p> <p>Mund të thërras dhe detyrojë paraqitjen e personave para komisionit, si dhe mund t'i detyrojë ata të japin dëshmi verbale apo me shkrim nën betim.</p>	<p>Mund t'i kërkojë secilit ministër, shefit të shërbimit të inteligjencës apo IP-së që të paraqitet para tij;</p> <p>Ka të drejtë të mbajë dëgjime dhe të obligojë praninë e dëshmitarëve.</p>	<p>Mund të kërkojë nga ministrat dhe zyrtarët tjerë të dëshmojnë.</p>

	Belgjikë	Kanada	Afrika e jugut	Mbretëria e Bashkuar
Qasja ndaj informatave të klasifikuara	<p>Qasje ndaj gjitha informatave që konsiderohen të nevojshme;</p> <p>Shërbimet e inteligjencës duhet, me iniciativë vetanake, të furnizojnë komisionin me gjitha rregullat e brendshme dhe direktivat.</p>	<p>Qasje e pakufizuar ndaj gjitha informatave të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tij.</p>	<p>Disa kufizime në qasjen ndaj informatave që mbahen nga shërbimet e inteligjencës;</p> <p>Emrat e agjentëve dhe/ose burimet mund të mos jepen tek komisioni.</p>	<p>Ministri përgjegjës mund të kufizojë qasjen e komisionit ndaj informatave të ndjeshme që do të mund të zbulonin hollësi të operacioneve, apo burimeve dhe metodave të shërbimeve inteligjente.</p>
Inicimi i hetimeve	<p>Iniciativa vetanake;</p> <p>Ankesa;</p> <p>Kërkesa e parlamentit; kërkesa e ministrit përgjegjës.</p>	<p>Iniciativa vetanake;</p> <p>Ankesa;</p> <p>referim nga Komisioni Kanadez për të Drejta të njeriut.</p>	<p>Mund të hartojë një raport special me kërkesë të parlamentit, apo ministrit(ave) përgjegjës.</p>	<p>Iniciativa vetanake;</p> <p>Me kërkesë të ministrit përgjegjës.</p>
Inicimi i hetimeve	<p>Raport obligativ vjetor tek presidenti i dy dhomave të parlamentit dhe ministri përgjegjës;</p> <p>Raportet speciale më së pari i dorëzohen ministrit përgjegjës, pastaj Senatit (Dhoma e Lartë). Raportet për parlamentin nuk përmbajnë informata të fshehta.</p>	<p>Raport obligativ vjetor;</p> <p>Raportet i dërgohen më së pari ekzekutivit, i cili duhet ta paraqesë raportin para parlamentit brenda 15 ditësh;</p> <p>Lëshon raporte speciale kur kërkohet nga ministri apo me iniciativën e vet;</p> <p>Obligimi për t'u konsultuar me drejtorin e shërbimit të inteligjencës para publikimit të ndonjë raporti.</p>	<p>Raporti obligativ vjetor tek parlamenti dhe presidenti, si dhe ministri(at) përgjegjës;</p> <p>Raportet nuk mund të përmbajnë informata që mund të jenë të dëmshme për sigurinë kombëtare.</p>	<p>Raport obligativ vjetor;</p> <p>Mund të lëshojë raporte mbi çështje të caktuara;</p> <p>Gjitha raportet i dërgohen më së pari kryeministrit, i cili pastaj i dorëzon në parlament;</p> <p>Kryeministri vendos cilat informata duhen hequr nga versioni publik i raportit.</p>

Studim i thellë i organeve parlamentare dhe profesionale për mbikëqyrjen e inteligjencës

Kjo pjesë hulumton rolin që e kanë komisionet parlamentare të specializuara për mbikëqyrje dhe organet profesionale të mbikëqyrjes. Ajo trajton çështjet e mandateve të tyre; pushtetit; resurset; trajtimin e informatave të fshehta; marrëdhëniet me shërbimet e inteligjencës; pavarësinë; funksionet e raportimit, si dhe përfundimisht, përparësitë dhe mangësitë e të dyja organeve parlamentare dhe atyre profesionale të mbikëqyrjes.

Cilat aspekte të punës së shërbimeve të inteligjencës mbikëqyren nga organet parlamentare dhe/ose profesionale të mbikëqyrjes?

PKomisionet parlamentare dhe/ose organet profesionale të mbikëqyrjes, mbikëqyrin gjitha aspektet e shërbimeve të inteligjencës (shih Tabelën 2 për shembuj).

Ato fokusohen në katër fusha:

1. Mbikëqyrja e ligjshmërisë së operacioneve dhe politikave

Mbikëqyrësit vlerësojnë nëse politikat ekzistuese dhe gjitha aspektet e operacioneve inteligjente në vazhdimësi janë në përputhje me ligjet vendore dhe standardet ndërkombëtare. Ata gjithashtu vlerësojnë nëse operacionet dhe veprimtaritë e kryera të inteligjencës kanë përmbushur kërkesat ligjore. Përfundimisht, mbikëqyrësit shqyrtojnë edhe planet për operacionet e ardhme të inteligjencës, si dhe vendosin nëse ato veprimtari do të jenë në përputhje me ligjet ekzistuese, rregulloret dhe standardet ndërkombëtare.

2. Mbikëqyrja e efektshmërisë së operacioneve

Mbikëqyrësit monitorojnë efektshmërinë e operacioneve të inteligjencës. Ata përcaktojnë nëse shërbimet e inteligjencës kryejnë funksionet, aktivitetet dhe detyrat e tyre në mënyrë të efektshme dhe në pajtim me ligjin dhe politikat e prioritetet e ekzekutivit.

3. Mbikëqyrja e praktikave administrative

Mbikëqyrësit monitorojnë praktikat administrative të shërbimeve të inteligjencës. Përveç tjerash, ata hulumtojnë politikat e resurseve njerëzore dhe praktikat menaxhuese.

4. Mbikëqyrja e menaxhimit financiar

Mbikëqyrësit monitorojnë aktivitetet e brendshme financiare të shërbimeve të inteligjencës, duke përfshirë buxhetimin dhe shpenzimet e tyre.

Në disa sisteme, shtetet themelojnë vetëm një organ parlamentar apo profesional të mbikëqyrjes, për të monitoruar dhe vlerësuar aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës. Megjithatë, më shpesh, shtetet angazhojnë më shumë se një organ mbikëqyrës për të vëzhguar gjitha aspektet e punës së inteligjencës. Për shembull, shteti mund të ketë një komision parlamentar mbikëqyrës me përgjegjësi të monitorimit të efektshmërisë së veprimtarisë së inteligjencës, ndërsa t'i jap organit profesional të mbikëqyrjes përgjegjësinë për monitorimin e ligjshmërisë së aktiviteteve të tyre. Pa marrë parasysh përbërjen e saktë të sistemit të mbikëqyrjes, shtetet demokratike sigurohen që gjitha aspektet e aktiviteteve të shërbimeve të inteligjencës të mbikëqyren nga një apo më shumë organe të jashtme.

KÇfarë pushteti ligjor kanë organet e mbikëqyrjes?

Shtetet demokratike sigurojnë që rolet, mandatet dhe pushteti i organeve parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes të bazohen në ligje (shih Tabelën 2, shembujt). Ligji obligon ekzekutivin dhe shërbimet e inteligjencës të bashkëpunojnë me organet e mbikëqyrjes; kjo është thelbësore për kryerjen e detyrës së tyre.

Ligji u jep organeve mbikëqyrëse fuqinë e nevojshme për vëzhgimin e punës së shërbimeve të inteligjencës, gjë që është e domosdoshme për t'i mbajtur ata përgjegjës për veprimet e tyre.

Së pari, ligji i jep organeve të mbikëqyrjes fuqinë që të veprojnë në pavarësi dhe të fillojnë hetimet e veta pa pasur nevojë të marrin leje paraprake nga ekzekutivi apo shërbimet e inteligjencës.

Së dyti, ligji i jep organeve mbikëqyrëse qasjet e plotë ndaj gjitha informatave të nevojshme për punën e tyre, duke përfshirë dosjet sekrete të mbajtura nga shërbimet e inteligjencës. Qasja ndaj këtyre informatave është thelbësore për të përcaktuar nëse, mes tjerash, shërbimet e inteligjencës janë duke vepruar efektivisht dhe në përputhje me ligjin. Dështimi i një zyrtari të inteligjencës për të vepruar sipas kërkesës së organit mbikëqyrës për informata mund të konsiderohet vepër penale me ligj. Në shumë shtete, organi mbikëqyrës mund t'i kërkojë autoriteteve të zbatimit të ligjit të detyrojë individët që të zbatojnë kërkesat e tij për informata.

Së treti, organet e mbikëqyrjes kanë autoritetin që të thërrasin ministrat dhe zyrtarët përgjegjës për shërbime të inteligjencës që të ofrojnë përgjigje për pyetjet e tyre në lidhje me punën e inteligjencës. Në shumë shtete, këta individë duhet të dëshmojnë nën betim para organit të mbikëqyrjes.

Së fundi, organet mbikëqyrëse janë të lira të vizitojnë lokalet e shërbimeve të inteligjencës. Vizitat e tilla mund të organizohen paraprakisht me shërbimin e inteligjencës, apo të bëhen pa paralajmërim.

Pse kanë nevojë organet e mbikëqyrjes për resurse financiare dhe njerëzore?

Përveç kompetencave ligjore, organet mbikëqyrëse kanë nevojë për resurse financiare dhe njerëzore për të kryer rolin e tyre në mënyrë efektive. Organet mbikëqyrëse kanë nevojë për financim të mjaftueshëm për të angazhuar personel të përherëshëm dhe për të angazhuar shërbimet e ekspertëve të caktuar sipas nevojës. Ato kanë nevojë gjithashtu për pajisje, si kompjuterët. Duke marrë parasysh që trajtojnë informata tejet të ndjeshme, ato kanë nevojë për pajisje të sofistikuar kompjuterike dhe ekspertë teknikë për të vendosur sisteme të sigurisë.

Organet mbikëqyrëse angazhojnë personel të përherëshëm që kryen rolet që janë thelbësore për organizatën. Personeli kryen pjesën më të madhe të punëve të përditshme. Detyrat e tyre përfshijnë përgatitjen e inspektimeve, kryerjen e analizave të veprimtarisë së inteligjencës, si dhe raportimin mbi hetimet e organit mbikëqyrës. Derisa anëtarët e organeve parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes mund të ndryshojnë, personeli qëndron me organizatën për periudha më të gjata se anëtarët. Kështu, ata janë në gjendje të sigurojnë vazhdimësinë e duhur të veprimtarisë, si dhe t'i ofrojnë organizatës «kujtesën institucionale». Qëndrimi i tyre i gjatë iu jep atyre edhe njohurinë dhe ekspertizën në shumë aspekte të punës së inteligjencës.

Organet parlamentare të mbikëqyrjes zakonisht zgjedhin stafin që tanimë është në punë në parlament. Organet profesionale të mbikëqyrjes zakonisht punësojnë stafin jashtë qeverisë. Në të dyja rastet, personeli duhet të kalojë qarqet e sigurisë, për të siguruar që janë të besueshëm në trajtimin e informatave të ndjeshme në lidhje me shërbimet e inteligjencës.

Mbikëqyrja e shërbimeve të inteligjencës kërkon ekspertizë dhe njohuri për praktika komplekse, të cilat shumë pak njerëz jashtë komunitetit të inteligjencës i shohin. Kështu, në disa raste ata duhet të punësojnë ekspertë të inteligjencës për t'iu ndihmuar të bëjnë

hetime dhe në mënyrë efektive të merren me çështje komplekse në inteligjencë. Ngjashëm, shpesh kanë nevojë për ekspertë të teknologjisë informative dhe telekomunikacionit për t'iu ndihmuar atyre të kenë kuptim më të mirë të teknikave komplekse elektronike të cilat përdoren nga shërbimet e inteligjencës.

Si i monitorojnë mbikëqyrësit shërbimet e inteligjencës?

Organet parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes përdorin shumë metoda për të monitoruar veprimtarinë e shërbimeve të inteligjencës. Metodat e përdorura varen nga mandati i organit të mbikëqyrjes dhe fuqitë ligjore.

Së pari, ata lexojnë raportet e klasifikuara dhe të paklasifikuara që prodhohen nga shërbimet e inteligjencës. Raportet iu japin atyre informata të dobishme në lidhje me të gjitha aspektet e punës së inteligjencës. Kjo stimulon pyetje të mëtejshme që mund të çojë në kuptimin më të mirë të proceseve të brendshme.

Së dyti, ata bëjnë mostrimin e rëndomtë të informatave që shërbimet e inteligjencës kanë përpunuar apo ruajtur. Mostrimi i rëndomtë mund të bëhet gjatë inspektimeve të rregullta apo përmes vizitave të paparalajmëruara. Për shembull, nëse dëshirojnë të vlerësojnë se shërbimet e inteligjencës përdorin të dhënat personale në pajtim me ligjin, ata zgjedhin një numër të dosjeve individuale dhe kontrollojnë për të parë nëse këto mostra përputhen me kërkesat.

Së treti, ata bëjnë hulumtime tematike për të hulumtuar me kujdes një fushë specifike të punës së inteligjencës. Këto hetime zakonisht përqendrohen në fusha të gjera e jo në ngjarje apo veprime të veçanta. Organet e mbikëqyrjes shpesh zgjedhin tema në bazë të brengave të caktuara. Këto mund të ngriten nga publiku apo subjektet qeveritare dhe joqeveritare, shpesh si vazhdimësi e hetimeve apo inspektimeve të mëhershme.

Së katërti, ata gjithashtu bëjnë hetime të ngjarjeve apo pohimeve specifike në lidhje me shërbimet e inteligjencës. Ata fillojnë hetime të incidenteve të veçanta në detyrë zyrtare, apo i bëjnë ato kur ekzekutivi dhe/ose parlamenti ka hetime. Këto hetime hulumtojnë gjitha informatat relevante që mbahen nga shërbimet e inteligjencës në lidhje me ngjarjet dhe pohimet specifike.

Përfundimisht, disa organe parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes hetojnë ankesat e veçanta që parashtrihen individët (shih faqet 43-46). Duke hetuar ankesat specifike, mbikëqyrësit marrin një pasqyrë të problemeve të përgjithshme në punën e shërbimeve të inteligjencës. Organet e mbikëqyrjes kërkojnë vazhdimësi në ankesat që pranojnë; kjo mund të shërbejë si bazë për hetime të mëtutjeshme.

Si raportojnë organet e mbikëqyrjes mbi aktivitetet e tyre?

Përgjithësisht, ligji i kërkon organeve të mbikëqyrjes të hartojnë raporte vjetore publike mbi aktivitetet e tyre. Këto raporte zakonisht përmbajnë informata mbi anëtarësinë e tyre aktuale, hetimeve që kanë kryer, gjetjet e tyre, financat dhe rekomandimet e bëra. Rekomandimet i këshillojnë shërbimet e inteligjencës dhe ekzekutivin mbi mënyrat e përmirësimit të llogaridhënies, transparencës, ligjshmërisë dhe efektshmërisë.

Organet mbikëqyrëse mund të ofrojnë raporte shtesë brenda një viti të caktuar. Ato prodhojnë raporte të veçanta që përshkruajnë hetimet që kanë kryer mbi ngjarjet specifike apo temat e përgjithshme. Organet e mbikëqyrjes zakonisht prodhojnë dy versione të raporteve të tyre. Ata prodhojnë një version për ekzekutivin dhe shërbimet e inteligjencës, të cilat mund të përmbajnë informata të fshehta, si dhe një version të dytë për publikun, i cili përgjithësisht nuk përmban informata të fshehta. Organet e mbikëqyrjes konsultohen me ekzekutivin dhe shërbimet e inteligjencës para lëshimit të raporteve publike. Ky konsultim i jep ekzekutivit dhe shërbimeve të inteligjencës mundësinë që të ndajnë brengat që mund t'i kenë në lidhje me përfshirjen e informatave të ndjeshme në raport.

Pse janë të rëndësishëm raportet publike?

Së pari, raportimi publik informon shoqërinë për veprimtarinë e shërbimeve të inteligjencës, derisa gjithashtu promovon kuptimin publik dhe besimin e tyre në organin mbikëqyrës të inteligjencës.

Së dyti, mbikëqyrësit përdorin raportet e tyre për t'u munduar të sjellin ndryshime brenda shërbimeve të inteligjencës, në politikat e ekzekutivit mbi inteligjencën, apo në legjislacionin që rregullon aktivitetet e inteligjencës. Raportet e organeve të mbikëqyrjes shpesh përmbajnë rekomandime mbi përmirësimin e politikave dhe praktikave të caktuara. Mbikëqyrësit mund të përcjellin ato rekomandime në vitet vijuese për të mbajtur shërbimet e inteligjencës dhe ekzekutivin përgjegjës për adres-

imin e problemeve më parë të identifikuara në organizatën e tyre.

A ka konflikt mes të drejtës për të ditur dhe nevojës për të mbajtur informatat sekrete?

Për të monitoruar shërbimet e inteligjencës, organet parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes kërkojnë informata të hollësishme për aktivitetet e tyre. Në shumicën e shteteve demokratike ato kanë të drejtë ligjore që t'i qasen gjitha informatave përkatëse për punën e tyre. Në anën tjetër, shërbimet e inteligjencës kanë nevojë të mbrojnë informatat, të cilat, nëse bëhen publike, do të mund të dëmtonin hetimet në vazhdim apo t'i ekspozonin metodat dhe burimet e përdorura për grumbullimin e informatave. Zbulimi publik i informatave të tilla do të mund të ishte i rrezikshëm edhe për sigurinë kombëtare. Shërbimet e inteligjencës shpesh ngurrojnë që t'i sigurojnë mbikëqyrësve qasje të plotë ndaj informatave të tyre, sepse frikësohen që informatat e klasifikuara mund të rrjedhin.

Përveç këtyre, shumë shërbime të inteligjencës brenghosen që mbikëqyrësit do të mund të dëmtonin obligimet e tyre për fshehtësi në lidhje me të dhënat personale. Ligji i kërkon shërbimeve të inteligjencës dhe personelit të tyre që të trajtojnë të dhënat personale si konfidenciale si dhe kufizon këmbimin e informatave të tilla.

Duke pasur parasysh kërkesat konkurrenente për informatat e shërbimeve të inteligjencës, ka një potencial për konflikt mes shërbimeve të inteligjencës dhe mbikëqyrësve në lidhje me qasjen ndaj informatave. Megjithatë, ekzistojnë disa masa për parandalimin e konflikteve të tilla (shih më poshtë).

Si mund të përafrohen nevojat për informata të organeve mbikëqyrëse dhe shërbimeve të inteligjencës?

Masat e veçanta ndihmojnë në të siguarit që organet mbikëqyrëse të trajtojnë informatat e klasifikuara si të tilla. Këto masa ndihmojnë në të siguarit e shërbimeve inteligjente që mbikëqyrësit nuk do të zbulojnë informata të ndjeshme.

Së pari, organet parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes mbajnë shumicën e takimeve të tyre në mënyrë private. Përmbajtja e këtyre takimeve nuk bëhet publike.

Së dyti, është praktikë e zakonshme në shtetet demokratike që zbulimi i informatave të klasifikuara është vepër penale. Në shumë shtete, anëtarët e or-

ganeve mbikëqyrëse dhe personeli i tyre duhet të marrin çertifikatën e sigurisë para se të kenë qasje në informata të klasifikuara. Kjo do të thotë që ata kontrollohen për të siguruar që kanë besimin e duhur për të pasur qasje në informata konfidenciale. Përveç kësaj, mbikëqyrësit mund të kenë nevojë të nënshkruajnë marrëveshje të veçanta ku deklarojnë që nuk do të zbulojnë informata të klasifikuara.

Së treti, organet mbikëqyrëse kanë nevojë të marrin masa për të parandaluar zbulimin e informatave të tilla. Ata zakonisht miratojnë politika që i ndalojnë anëtarëve dhe personelit që të nxjerrin informatat e klasifikuara jashtë lokaleve të caktuara. Gjithashtu, mund të ketë edhe masa të veçanta të sigurisë për të mbrojtur dokumentet elektronike dhe ato në letër që përmbajnë informata të ndjeshme.

Së fundmi, ligjet mbi mbrojtjen e të dhënave personale vlejnë edhe për organet mbikëqyrëse sikurse për çdo institucion tjetër publik. Ligji obligon organet mbikëqyrëse që t'i mbajnë të dhënat personale si konfidenciale. Organet mbikëqyrëse mund t'i zbulojnë ato vetëm me pëlqimin e personit në fjalë, si dhe në pajtim me kriteret tjera specifike të përcaktuara me ligj.

Pse është e rëndësishme marrëdhënia mes shërbimeve të inteligjencës dhe organeve mbikëqyrëse?

Organet mbikëqyrëse përgjithësisht mundohen të zhvillojnë një raport konstruktiv me shërbimet e inteligjencës që i vëzhgojnë. Kjo bëhet për shkak se është e vështirë për mbikëqyrësit që të monitorojnë shërbimet e inteligjencës në mënyrë të mirëfilltë pa bashkëpunimin e tyre. Mbikëqyrësit varen nga vetë shërbimet e inteligjencës për të siguruar qasjen në informatat e duhura. Organet e mbikëqyrjes mund të fitojnë besimin e shërbimeve të inteligjencës duke trajtuar informatat e klasifikuara me kujdes dhe duke i mbajtur të informuar mbi veprimtarinë e mbikëqyrjes.

Shërbimet e inteligjencës gjithashtu përfitojnë nga marrëdhënia konstruktive e punës me organet e mbikëqyrjes. Në disa raste, raportet e mbikëqyrjes mund t'i ndihmojnë edhe inteligjencës që të argumentojë kërkesën për më shumë resurse financiare dhe njerëzore. Përveç kësaj, nëse bëhen pohime për shërbimet e inteligjencës, hetimi nga organi mbikëqyrës mund të ndihmojë në rivendosjen e besimit publik tek ato. Organet e mbikëqyrjes kanë gjithashtu një rol për të luajtur në mbrojtjen e shërbimeve të inteligjencës nga keqpërdorimi i mundshëm nga ekzekutivi. Zyrtarët e inteligjencës mund të raportojnë urdhra të papërshtatshëm apo të pa-

ligjshëm që marrin tek organi i mbikëqyrjes. Duke marrë parasysh këto përfitime, është përgjithësisht në interesin e shërbimeve të inteligjencës që të bashkëpunojnë me organet e mbikëqyrjes.

Derisa marrëdhënia e punës duhet të jetë konstruktive, nuk duhet të jetë edhe tejet e afërt. Publiku do t'i perceptojë organet e mbikëqyrjes si të pavarura, si dhe efektive, vetëm nëse mbajnë një lloj distance nga shërbimet e inteligjencës

Si e sigurojnë shoqëritë demokratike pavarësinë e organeve të mbikëqyrjes së inteligjencës?

Organet parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes janë organizata të pavarura. Ato nuk mund të jenë pjesë e ekzekutivit apo shërbimeve të inteligjencës pasi ato duhet të mbikëqyrin mbledhjen dhe përdorin informatave të inteligjencës.

Shtetet demokratike miratojnë ligje që i japin organeve për mbikëqyrjen e inteligjencës identitet të pavarur ligjor. Qëllimi i këtyre ligjeve është që të mbrojnë pavarësinë e tyre organizative dhe operative.

Këto ligje autorizojnë organet mbikëqyrëse që të organizojnë aktivitetet e tyre pa ndërhyrje nga shërbimet e inteligjencës apo ekzekutivi. Për shembull, ato përzgjedhin rastet apo temat që do t'i hetojnë dhe vendosin se si do t'i kryejnë hetimet. Identiteti i pavarur ligjor i organeve mbikëqyrëse nënkupton që ato nuk mund të marrin asnjë instruksion nga ekzekutivi apo shërbimet e inteligjencës.

Organet mbikëqyrëse gjithashtu mund të vendosin në mënyrë të pavarur se në cilat informata të shërbimeve të inteligjencës duhet të kenë qasje ata. Qasja në informata e garantuar me ligj siguron që as shërbimet e inteligjencës e as ekzekutivi të mos mund ta kontrollojnë punën e organeve mbikëqyrëse përmes kufizimit të qasjes së tyre në informata. Në disa raste organet mbikëqyrëse mund të mbështeten tek gjykatat për të kërkuar nga shërbimet e inteligjencës që t'iu lejojnë atyre qasje në informata relevante.

Organet mbikëqyrëse gjithashtu mund të marrin vendime të pavarura lidhur me raportimin. Në praktikë, organet mbikëqyrëse konsultohen me shërbimet e inteligjencës dhe ekzekutivin para publikimit të raportit. Mirëpo, ekzekutivi dhe shërbimet e inteligjencës nuk kanë asnjë mundësi juridike për t'i ndaluar organet mbikëqyrëse që të bëjnë publikimin e gjetjeve të pavarura dhe rekomandimeve në raportet e tyre.

Në shumë shtete demokratike, organet e mbikëqyrjes së inteligjencës kanë edhe pavarësi buxhetore. Kjo nënkupton që ato mund të kërkojnë financa për vete nga parlamenti dhe t'i menaxhojnë vetë buxhetet e tyre. Për shkak se janë financiarisht të pavarura, organizatat tjera (p.sh ekzekutivi, shërbimet e inteligjencës nuk mund të ndikojnë në vendimet e tyre duke i kërcënuar ata me shkurtime të financave.

Si mund të sigurohet pavarësia e anëtarëve të organeve të mbikëqyrjes?

Pavarësia e organeve të mbikëqyrjes garantohej vetëm nëse anëtarët dhe stafi i tyre ruajnë pavarësinë. Kjo nënkupton që ata nuk i keqpërdorin pozitat e tyre për përfitime personale apo avansim të intereseve të tjerëve. Prandaj shoqëritë demokratike nxjerrin ligje për tu siguruar që individët e emëruar në organet mbikëqyrëse ta ruajnë pavarësinë.

Zakonisht, ligji rregullon përzgjedhjen e anëtarëve të organeve mbikëqyrëse. Në shumë shtete, parlamenti emëron anëtarët e organeve mbikëqyrëse. Kjo nënkupton që mbikëqyrësit përzgjedhen nga një institucion që është i pavarur nga ata që mbikëqyrin. Kjo është e nevojshme për të siguruar pavarësinë e personave që shërbejnë në organet mbikëqyrëse. Në disa shtete, ekzekutivi është përgjegjës për emërimin e anëtarëve të organeve mbikëqyrëse mirëpo përzgjedhja nga ai duhet të merr miratimin e parlamentit dhe në disa raste edhe të gjyqësorit .

Fakti që anëtarët e organeve mbikëqyrëse emërohen për mandat të caktuar i jep atyre pavarësi shtesë dhe i mbron ata kundër presionit të jashtëm. Pasi që mandati përcaktohet me ligj, politikanët nuk mund t'i shkarkojnë ata në mënyrë arbitrare. Shkarkimet janë të mundshme nëse personi ka kryer vepër të rëndë apo ka dështuar në kryerjen e detyrave të tij/saj. Në disa shtete, ligji nuk i lejon anëtarët e organeve mbikëqyrëse që ta kenë mandatin e dytë. Me kufizimin e mandateve në një, ligjvënësit kanë menduar që t'i parandalojnë anëtarët e organeve mbikëqyrëse nga keqpërdorimi i pozitës së tyre, me qëllim të ndikimit të vendimeve për riemërimin e tyre.

Si masë shtesë për sigurimin e pavarësisë, ligji mund t'i ndalojë anëtarët e këtyre organeve nga mbajtja e pozitave tjera. Për shkaqe të ditura, anëtarët e organeve mbikëqyrëse nuk mund të shërbejnë në shërbimet e inteligjencës. Por, ligji gjithashtu mund t'i ndalojë mbikëqyrësit nga mbajtja e anëtarësisë

në një parti politike apo në angazhimin në aktivitete komerciale. Kjo ndihmon në parandalimin e konflikteve të mundshme të interesit.

Cilat janë përparësitë e organeve parlamentare të mbikëqyrjes?

Organet parlamentare të mbikëqyrjes kanë dy përparësi kryesore kur krahasohen me ato eksperte. Së pari, si dhe më me rëndësi, mbikëqyrja parlamentare ka më shumë "legjitimitet demokratik", pasi kryhet nga njerëzit e zgjedhur; ata që mbikëqyrin shërbimet e inteligjencës kanë lidhje direkte me publikun. Në dallim prej tyre, anëtarët e organeve profesionale të mbikëqyrjes kanë vetëm legjitimitet indirekt sepse normalisht zgjedhen ose nga parlamenti ose nga ekzekutivi.

Së dyti, organet parlamentare të mbikëqyrjes kanë pozitë më të mirë që të ndikojnë direkt në politika dhe aktivitete të ekzekutivit dhe shërbimeve të inteligjencës. Parlamenti ka dy vegla në dispozicion në këtë drejtim: mund të jetë në gjendje të miratojë apo ndryshojë legjislacionin mbi shërbimet e inteligjencës; mundet gjithashtu të shfrytëzojë pushtetin e vet për të miratuar apo refuzuar buxhetet, për të bindur ekzekutivin dhe/ose shërbimet e inteligjencës që të ndryshojë politikat apo praktikat. Kjo do të thotë që gjetjet dhe rekomandimet e organeve parlamentare të mbikëqyrjes mundën shpejt të ndikojnë vendimet dhe të shtyjnë ndryshimet në legjislacion dhe buxhet të inteligjencës. Organet profesionale të mbikëqyrjes nuk i kanë këto instrumente në dispozicion për të ndikuar ekzekutivin dhe shërbimet inteligjente. Në shumicën e rasteve, ato mundën vetëm të lëshojnë gjetjet dhe rekomandimet për parlamentin, ekzekutivin dhe shërbimet e inteligjencës.

Cilat janë përparësitë e organeve profesionale të mbikëqyrjes?

Në krahasim me homologët e tyre parlamentarë, organet profesionale të mbikëqyrjes ofrojnë përparësi të konsiderueshme.

Së pari, organet profesionale të mbikëqyrjes zakonisht janë të pavarura nga ndikimet politike përdërisa mbikëqyrja parlamentare mund të politizohet. Anëtarët e komisioneve parlamentare të mbikëqyrjes kanë më shumë prirje të shfrytëzojnë pozitat e tyre për qëllime politike. Ky është problem i veçantë për anëtarët e parlamentit që i përkasin partisë në pushtet. Ata mund të mos kenë vullnetin të

hetojnë veprimtari të caktuara të shërbimeve të inteligjencës që mund të zbulojnë gjetje që dëmtojnë apo turpërojnë ekzekutivin. Kjo rrjedh nga dëshira e parlamentarëve që të mbrojnë partinë e tyre politike si dhe potencialisht edhe ambiciet politike. Për dallim nga kjo, anëtarët e komisioneve parlamentare mbikëqyrëse nga partitë opozitare mund të shfrytëzojnë pozitat e tyre për të sulmuar qeverinë. Për shembull, ata mund të mundohen të iniciojnë hetime me qëllim të dëmtimit të qeverisë më shumë se sa për vetë zbatimin e mandatit të tyre të përgjithshëm të mbikëqyrjes. Ky realitet i pengon komisionet parlamentare në ndërmarrjen e plotë të mbikëqyrjes së paanshme të shërbimeve të inteligjencës.

Së dyti, për dallim nga parlamentarët, anëtarët e organeve profesionale të mbikëqyrjes mund të përqendrohen ekskluzivisht në mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës. Parlamentarët që shërbejnë në komisione të mbikëqyrjes së inteligjencës përqendrohen në më shumë sesa vetëm shërbimet e inteligjencës. Për shembull, ata marrin pjesë në debate plenare, shërbejnë në komisione tjera si dhe shpenzojnë kohë në takimin e zgjedhësve të tyre.

Së treti, anëtarët e organeve profesionale të mbikëqyrjes zakonisht mbesin në zyrat e tyre për periudha më të gjata sesa anëtarët e komisioneve parlamentare. Periudhat më të gjata në punë të tilla i japin mundësi anëtarëve të këtyre organeve të zhvillojnë njohuritë dhe ekspertizën në fushën e inteligjencës. Anëtarët që shërbejnë në komisionet parlamentare priren të lënë pozitën më shpesh, si dhe përgjithësisht nuk zhvillojnë të njëjtin nivel të njohurive dhe ekspertizës.

Përfundimisht, pasi anëtarët e organeve profesionale të mbikëqyrjes kanë përgjithësisht më pak mundësi të ndikohen nga politika, ndoshta kanë edhe më pak mundësi të zbulojnë informata të ndjeshme për qëllime politike. Gjithashtu, ekzistojnë shpesh numra më të shumtë të parlamentarëve që shërbejnë në komisione që kanë qasje në informata të klasifikuara në krahasim me anëtarët e organeve profesionale të mbikëqyrjes. Kështu, komisionet parlamentare kanë më shumë mundësi të keqpërdorin informata të ndjeshme për arsye politike, si rrjedhja e informatave për të diskredituar kundërshtarët politikë. Shërbimet e inteligjencës i japin vlerë të madhe sigurisë së informatave të tyre. Në shumë shtete, shërbimet e inteligjencës përgjithësisht nuk i besojnë parlamentit, si dhe mund të frikësohen që anëtarët

e komisioneve parlamentare mbikëqyrëse do të zbulojnë informata të klasifikuara.

Ankesat ndaj shërbimeve të inteligjencës

Si mund të parashtrohet ankesa ndaj shërbimeve të inteligjencës?

Në shoqëritë demokratike, individët kanë të drejtë të ankohen kundër secilit veprim që është ndër-marrë ndaj tyre nga një institucion publik, duke përfshirë këtu edhe shërbimet e inteligjencës. Secili person mund të sfidojë veprimin që shërbimi i inteligjencës mund të ketë ndërmarrë ndaj tyre, duke përfshirë arrestimin dhe mbajtjen, bastisjen e shtëpisë apo përgjimit të komunikimeve të tyre.

Personat që besojnë se janë trajtuar padrejtësisht apo në mënyrë të paligjshme nga shërbimet e inteligjencës parashtrojnë ankesat e tyre tek organi i pavarur (shih Kutinë 9 për shembuj se si ankesat për shërbimet inteligjente mund të trajtohen). Ky organ i shqyrtimit të ankesave është normalisht një gjykatë apo një organ jo-gjyqësor, si Ombudspersoni apo një organ profesional i mbikëqyrjes së inteligjencës. Ky organ së pari duhet të vlerësojë nëse shërbimi i inteligjencës ka vepruar ndaj personit në fjalë, si dhe nëse po, a ka përdorur kompetencat e veta në përputhje me ligjin.

Nëse organi i shqyrtimit të ankesave gjen që ankesa është e vlefshme, mund të kërkojë apo urdhërojë shërbimin e inteligjencës që të korrigjojë situatën. Shembuj të shpeshtë të korrigjimeve përfshijnë pagesën e një kompensimi financiar apo shlyerjen e informatave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Statusi i organeve të shqyrtimit të ankesave përcakton nëse ai organ mund të lëshojë urdhra obligativë për shërbimet e inteligjencës. Organet gjyqësore mund të lëshojnë urdhra obligativë të cilat duhen zbatuar nga shërbimet e inteligjencës. Në shumicën e shteteve, organet jo-gjyqësore si organet profesionale të mbikëqyrjes dhe Ombudspersoni, mund të lëshojnë rekomandime për shërbimet e inteligjencës. Ato nuk janë ligjërisht të obliguar t'i zbatojnë rekomandimet e tilla por organi i shqyrtimit të ankesave mund të jetë në gjendje të raportojë mbi mospërputhjet e tilla tek ekzekutivi, si dhe mund të shkojë edhe në media.

Kutia 9: Trajtimi i ankesave nga Komisioni Shqyrtues i Shërbimit Kanadez të Sigurisë dhe Inteligjencës¹³

Përveç mbikëqyrjes së veprimtarive të Shërbimit Kanadez të Sigurisë dhe Inteligjencës, Komisioni Shqyrtues heton ankesat që bëhet kundër shërbimit të inteligjencës. Komisioni mban seanca dëgjimore me dyer të mbyllura dhe ka autoritetin e gjykatës për të ftuar dëshmitarët dhe për të marrë dëshmi nën betim. Nenet e mëposhtme të Ligjit për Sistemin e Sigurisë dhe Inteligjencës përkufizojnë këtë proces:

Neni 41.

1. Çdo person mund të parashtojë një ankesë në Komisionin Shqyrtues lidhur me ndonjë veprim apo gjë të kryer nga Shërbimi i Inteligjencës dhe Komisioni, në bazë të nën-nenit 2, heton ankesën nëse:
 - a. ankuesi ka parashtruar një ankesë te drejtori lidhur me ndonjë veprim apo gjë të kryer dhe ankuesi nuk ka marrë përgjigje brenda periudhës kohore të cilën komisioni konsideron si të arsyeshme apo nuk është i kënaqur me përgjigjen e dhënë; dhe
 - b. komisioni konsideron që ankesa nuk është e parëndësishme, e pavlerë, shqetësuese apo e parashtruar me qëllim të keq.

Neni 45.

Siç përcaktohet me këtë pjesë, një ankesë do t'i dorëzohet Komisionit Shqyrtues me shkrim përveç nëse Komisioni përcakton ndryshe.

Neni 48.

1. Siç përcaktohet me këtë pjesë, çdo hetim i një ankese nga Komisioni Shqyrtues do të kryhet në mënyrë konfidenciale.
2. Siç përcaktohet me këtë pjesë, gjatë hetimit të një ankese nga Komisioni Shqyrtues, ankuesi, zëvendësi gjegjës apo drejtori do ta kenë mundësinë e përfaqësimit para Komisionit Shqyrtues për të paraqitur dëshmitë dhe për t'u dëgjuar personalisht apo për të dhënë këshilla, por askujt nuk i takon e drejta për të qenë i pranishëm, për të pasur qasje apo për të dhënë komente ndaj përfaqësimit të ndonjë personi tjetër që bëhen para Komisionit Shqyrtues.

Neni 50.

Në lidhje me hetimin e ndonjë ankese që përcaktohet me këtë pjesë, Komisioni Shqyrtues ka autoritetin për:

1. të ftuar dhe për të detyruar paraqitjen e personave para Komisionit dhe për t'i detyruar ata që të japin një dëshmi nën betim me gojë apo me shkrim, si dhe për të paraqitur dokumente apo gjëra të cilat Komisioni i konsideron si të domosdoshme për një hetim të plotë dhe me qëllim të vlerësimit të ankesës po në të njëjtën mënyrë dhe gjerë në të njëjtën shkallë si një gjykatë e lartë;
2. të administruar betimet, dhe
3. të marrë dhe për të pranuar dëshmitë e tilla dhe informata, ose nën betim, ose me dëshmi nën betim, siç e sheh të arsyeshme Komisioni, pa marrë parasysh nëse apo jo dëshmia apo informata e tillë do të pranohet nga gjykata.

Neni 52.

1. Komisioni Shqyrtues
 - a. pas përfundimit të një hetimi lidhur me një ankesë sipas nenit 41, do t'ia dorëzojë Ministrit dhe Drejtorit një raport me të gjeturat e hetimit dhe me ndonjë rekomandim që komisioni e konsideron si të duhur; dhe
 - b. në të njëjtën kohë apo pas dorëzimit të raportit sipas paragrafit a, do t'ia raportojë të gjeturat e hetimit ankuesit dhe mund, nëse konsideron si të arsyeshme, t'ia raportojë ankuesit rekomandimet e përmendura në atë paragraf.

Cilat institucione trajtojnë ankesat për shërbimet e inteligjencës?

Në shumë shtete, individët mund t'i parashetrojnë ankesat ndaj shërbimeve të inteligjencës te avokati i popullit apo ndonjë institucion për të drejtat e njeriut dhe/apo në gjykata e rregullta. Megjithatë, një numër në rritje i shteteve kanë themeluar mekanizmat e veçantë për trajtimin e ankesave, gjyqësore dhe jo-gjyqësore, për të pranuar ankesat lidhur me ankesat ndaj shërbimeve të inteligjencës. Organet e specializuara të mbikëqyrjes po ashtu mund të veprojnë si mekanizma jo-gjyqësor për shqyrtimin e ankesave.

Shtetet zakonisht preferojnë që t'ia besojnë trajtimin e ankesave ndaj shërbimeve të tyre të inteligjencës institucioneve të specializuara sesa gjykatave të rregullta dhe atë për dy arsye. Së pari, organet e tilla kanë personelin i cili ka kaluar verifikimin e sigurisë dhe kanë procedura për të trajtuar informatat e klasifikuara rregullisht. Së dyti, një organ i specializuar gjyqësor apo jo-gjyqësor mund të ketë njohuri për çështjet e inteligjencës; njohuri kjo që i mungon gjykatave të rregullta, avokatit të popullit apo institucionit për të drejtat e njeriut.

Është praktikë e mirë që të krijohen procedura e apelimit ndaj vendimeve të mekanizmave të

specializuar për trajtimin e ankesave. Zakonisht, gjykatat e rregullta procedojnë me ankesat e tilla.

Përse disa shtete njoftojë qytetarët kur autoriteti i veçantë përdoret kundër tyre?

Një proces i shqyrtimit të ankesave parasheh se individët janë të vetëdijshëm për masat që janë marrë kundër tyre nga shërbimet e inteligjencës. Kjo nuk është gjithmonë kështu kur shërbimet e inteligjencës përdorin autoritetin e veçantë në mënyrë të fshehtë, si për shembull duke mbikëqyruar komunikimin e një personi. Nëse qytetarët nuk kanë njohuri për veprimet që ndërmerren kundër tyre, atëherë ata nuk mund të sfidojnë ato veprimet duke parashtruar një ankesë. Ata as nuk e dinë nëse veprimet e tilla do të ndikojnë jetën e tyre. Për shkak se individët nuk mund të sfidojnë veprimet e tilla, një numër në rritje i shteteve demokratike përcaktojnë që shërbimet e inteligjencës duhet të informojnë qytetarët për masat e fshehta që përdoren kundër tyre.

Ky lajmërim zakonisht ndodh pas një afati të caktuar kohor dhe vetëm nëse nuk rrezikon hetimet apo nuk zbulon ndonjë burim të veçantë apo metodat që përdoren nga shërbimet e inteligjencës. (shih Kutinë 10).

Kutia 10: Ligji gjerman për njoftimin e individëve pas përdorimit të autoritetit të veçantë kundër tyre¹⁴

Shumë shtete evropiane përcaktojnë që shërbimet e tyre të inteligjencës duhet të informojnë personat kundër të cilëve është përdorur autoriteti i veçantë. Fragmenti në vijim nga ligji gjerman tregon për fushëveprimin e kësaj dispozite. Njoftimi nuk ndodh në të gjitha rastet dhe mund të shtyhet në baza të veçanta. Në Gjermani, një organ mbikëqyrës profesional (Komisioni G0) mbikëqyr respektimin e këtyre rregulloreve nga shërbimet e inteligjencës.

- Personi do të informohet për masat e fshehta në bazë të nenit 3, pas përfundimit të këtyre masave.
- Njoftimi i tillë do të mbahet përderisa nuk vendoset që njoftimi i palës do të rrezikojë qëllimin e kufizimit apo përderisa nuk parashihen dëme të përgjithshme ndaj interesave të federatës apo njësisë federale.
- Nëse njoftimi i tillë mbahet, sipas pikës 2, edhe 12 muaj pas përfundimit të masave, vazhdimi i mbajtjes së tij do t'i nënshtrohet miratimit të Komisionit G10. Komisioni G10 do të përcaktojë kohëzgjatjen e mbajtjes së tillë të vazhduar.
- Nuk do jetë i domosdoshëm asnjë njoftim, nëse Komisioni G10 njëzëri gjen se:
 1. një prej kushteve të përcaktuara me pikën 2 vazhdon të zbatohet edhe për 5 vjet pas përfundimit të masave,
 2. jështë praktikisht e sigurt që një gjendje e tillë do të zbatohet edhe në të ardhmen,
 3. kushtet që kanë të bëjnë me fshirjen zbatohen për agjencinë e mbledhjes së informatave dhe agjencisë pranuese.

Çfarë e bën efektiv një organ të shqyrtimit të ankesave?

Sikurse organet e mbikëqyrjes, organet e shqyrtimit të ankesave janë të pavarura edhe nga ekzekutivi edhe nga shërbimet e inteligjencës. Ato kanë nevojë për pushtet ligjor që t'i qasen gjitha informatave, zyrtarëve dhe lokaleve për të hetuar një ankesë.

Organet e shqyrtimit të ankesave janë më efektive nëse mund të lëshojnë urdhra që janë ligjërisht obligative për shërbimet e inteligjencës. Për shembull, ky pushtet i mundëson atyre t'i obligojnë shërbimet e inteligjencës që të paguajnë kompensim për një individ që është trajtuar gabimisht nga një zyrtar i inteligjencës. Ngjashëm, ato mund të kërkojnë nga shërbimet e inteligjencës që të shkatërrojnë informatat që janë marrë përmes shkeljes së paligjshme të drejtave të një individi.

Për të qenë efektive në hetimin dhe korrigjimin e shkeljeve të drejtave të njeriut, organet e shqyrtimit të ankesave duhet të jenë lehtësisht të qasshme. Publiku duhet të jetë i vetëdijshëm që organet e shqyrtimit të ankesave ekzistojnë dhe që janë në gjendje të parashtrijnë ankesa nëse ka nevojë. Këto organe marrin masa të caktuara për të siguruar qasshmërinë e tyre. Së pari, ata e bëjnë publik rolin e tyre dhe ofrojnë informata mbi mënyrën e parashtrimit të ankesave. Për shembull, ato krijojnë faqe në internet dhe botojnë fletushka në ndërtesa publike. Së dyti, sigurohen që të mos ketë shpenzime për parashtrimin e ankesave. Përfundimisht, garantojnë që ankesat do të trajtohen në mënyrë konfidenciale. Kjo është thelbësore për mundësimin e parashtrimit të ankesave pa frikën e hakmarrjes nga shërbimet e inteligjencës.

Për lexim të mëtejshëm

Born, Hans and Ian Leigh, Making Intelligence Accountable, (DCAF/Norwegian Parliament: Oslo, 2005). Në dispozicion në gjuhët e mëposhtme:

Shqip, Arabisht, Bullgarisht, Kroate, Dari, Indonezisht, Maqedonase, Anglisht, Gjeorgjiane, Ruse, Serbe, Pashto, Spanjisht, Turqisht, Ukrainase.

<http://www.dcaf.ch/publications/kms/details.cfm?id=18718&nav1=5>

DCAF Toolkit, Legislating for the security sector, Intelligence Legislation Model – Argentina, National Intelligence Law (and associated decrees), 2001.

DCAF Toolkit, Legislating for the security sector, Intelligence Legislation Model – Canada, Canadian Security Intelligence Service Act, 1985.

DCAF Toolkit, Legislating for the security sector, Intelligence Legislation Model – The Netherlands, Intelligence and Security Services Act 2002.

DCAF Toolkit, Legislating for the security sector, Intelligence Legislation Model – Brazilian laws on the intelligence services.

Commission of Inquiry Concerning Certain Activities of the Royal Canadian Mounted Police, Second Report, (Ottawa: Privy Council Office, 1981).

<http://epe.lac-bac.gc.ca/100/200/301/pco-bcp/commissions-ef/mcdonald1979-81-eng/mcdonald1979-81-eng.htm>

European Commission for Democracy Through the Law, (Venice Commission), Report on the democratic oversight of the security services, adopted by the Venice Commission at its 71st Plenary Session, CDL-AD(2007)016 (Venice, 1-2 June 2007).

[http://www.venice.coe.int/docs/2007/CDL-AD\(2007\)016-e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/2007/CDL-AD(2007)016-e.asp)

International Commission of Jurists, Eminent Jurists Panel, Assessing Damage Urging Action, Report of the Eminent Jurists Panel on Terrorism, Counter-terrorism and Human Rights (Geneva: ICJ, 2009).

<http://ejp.icj.org/IMG/EJP-Report.pdf>

Ministerial Review Commission on Intelligence in South Africa, Intelligence in a Constitutional Democracy, Final Report to the Minister for Intelligence Services, (Pretoria: 2008).

http://www.ssronline.org/edocs/review_commission_final_report20080910.doc

UN High Commissioner for Human Rights, Human Rights, Terrorism and Counter-Terrorism, Fact sheet No. 32, July 2008.

<http://www.ohchr.org/Documents/Publications/Factsheet32EN.pdf>

UN Human Rights Council, Compilation of good practices on legal and institutional frameworks and measures that ensure respect for human rights by intelligence agencies while countering terrorism, including on their oversight, A/HRC/14/46, 17 May 2010.

<http://www2.ohchr.org/english/bodies/hrcouncil/docs/14session/A.HRC.14.46.pdf>

Fund-notat

1. Ekstrakte nga nenet 12-15, Akti mbi Shërbimet e Inteligjencës së Sigurisë Kanadeze, 1984; neni 1, Akti mbi Sistemin e Inteligjencës së Sigurisë së Republikës së Kroacisë, 2006; si dhe neni 6 i Ligjit holandez për Shërbimet e Inteligjencës dhe Sigurisë 2002.
2. Ekstrakte nga Kushtetuta e Republikës së Afrikës Jugore, 1996, 198 -199, 209-210.
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), 16 dhjetor 1966, hyrja në fuqi më 23 mars 1976, neni 4; Komiteti i OKB-së për të Drejtat e njeriut, Komenti i përgjithshëm 29, Gjendja e jashtëzakonshme (neni 4), Dok. OKB-së CCPR/C/21/Rev.1/Add.11 (2001).
4. Konventat e Gjenevës 1-4, 12 gusht 1949, hyrja në fuqi më 21 tetor 1950.
5. ICCPR, neni 4; Komiteti i OKB-së për të Drejtat e njeriut, Komenti i Përgjithshëm 29, Gjendja e Jashtëzakonshme (neni 4); Dok. I OKB-së CCPR/C/21/Rev.1/Add.11 (2001). Parimet e Sirakuzës për Kufizimin dhe Shmangien e Dispozitave të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Shtojca Dok. OKB E/CN.4/1984/4 (1984);
6. Ekstrakte nga Akti mbi Shërbimet e Inteligjencës së Sigurisë Kanadeze, 1984, Neni 21.
7. Ekstrakte nga Akti Federal për Mbrojtjen e Kushtetutës, 1990, Nenet 10, 12, 3; dhe Akti G10 Act, 2001., Neni 15.
8. Ekstrakte nga Akti Federal Gjerman për Mbrojtjen e Kushtetutës, 1990, neni 15.
9. Ekstrakte nga Akti mbi Sistemin e Inteligjencës së Sigurisë së Republikës së Kroacisë, 2006
10. 10. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike: Akti i Parimeve për mbrojtjen e gjithë personave në çdo formë të paraburgimit apo burgimit, Shtojca e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme, A/RES/43/173, 9 dhjetor 1988; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve tjera të Vrazhda, Çnjerëzore apo Degraduese, miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe zbatim me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 39/46 të 10 dhjetorit 1984, hyrë në fuqi më 26 qershor 1987.
11. Parimet bazë të përdorimit të forcës dhe armëve të zjarrit nga zyrtarët e zbatimit të ligjit. Miratuar nga Kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimit dhe trajtimin e kryesve, Havanë, Kubë, 27 gusht deri më 7 shtator 1990; Kodi i Mirësjelljes për zyrtarët e zbatimit të ligjit, Miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 34/169 të 17 dhjetorit 1979; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, hyrë në fuqi më 23 mars 1976.
12. Ky material është nxjerrë nga Akti britanik i Shërbimeve të Inteligjencës 1994; Ministria Britanike e Drejtësisë, Qeverisja e Britanisë – Rishikimi Kushtetues, (Londër: HMSO, 2008); Belgjikë – Akti që rregullon shqyrtimin e shërbimeve policore dhe të inteligjencës si dhe Njësinë Koordinuese për Vlerësimin e Kërcënimeve, 1991; Akti mbi Shërbimet e Inteligjencës së Sigurisë Kanadeze, 1984; Afrika Jugore – Akti i Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Inteligjencës, Act 40, 1994; si dhe faqet e internetit të Komisionit të Vëzhgimit të Inteligjencës së Sigurisë (csars.gc.ca), si dhe Komisionit të Përhershëm të Shqyrtimit të Agjencive të Inteligjencës Belge (www.comiteri.be).
13. Ekstrakte nga Akti mbi Shërbimet e Inteligjencës së Sigurisë Kanadeze, 1984; si dhe faqja e Komisionit të Shqyrtimit të Inteligjencës së Sigurisë (SIRC): www.sirc-csars.gc.ca.
14. ekstrakte nga Akti G10, 2001, neni 12.

DCAF Geneva (Head Office)

For Visitors:

Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF)

Rue de Chantepoulet 11

CH-1201 Geneva

Switzerland

www.dcaf.ch